



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Program i studimit i Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në  
“Stomatologji”  
Universiteti “Aldent”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Vergjini MULO**

**Dr. Manola KELMENDI**

---

**Shkurt / 2024**

---

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Program i studimit i Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Stomatologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi i Integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.257 dt 27.02.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.114, Dt 18.07.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 25, datë 19.05.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	42 PAE / 22 PAK
18	Numri i studentëve (5 vitet e fundit)	Viti akademik 2018-2019 124 studentë; Viti akademik 2019-2020 126 studentë; Viti akademik 2020-2021 146 studentë; Viti akademik 2021-2022 161 studentë; Viti akademik 2022-2023 160 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

Universiteti Aldent u lincesua në bazë të VKM Nr. 673, datë 27.9.2006 “DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “ALDENT” si shkollë e lartë universitare jopublike. Me VKM Nr. 539, date 13.06.2013. ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private “Aldent” në universitet, me emërtimin Universiteti “Aldent”.

Universiteti “Aldent” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 27.01.2023 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti Aldent” me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 26.01.2028. Universiteti Aldent është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në tre njësi kryesore:

- **Fakulteti i Shkencave Dentare;**
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Ky program është licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 27.02.2008. Programi i studimit i Integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Dentare që përbëhet nga 3 njësi bazë:

- **Departamenti i Stomatologjisë;**
- Departamenti i Laborantëve Dentarë;
- Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik;

Programi i Studimit “Master i Shkencave” në “Stomatologji” është akredituar për herë të parë në vitin 2011, me Urdhër të MASH Nr.240, datë 26.05.2011, dhe është riakredituar në vitin 2017, sipas VBA Nr. 25, datë 19.05.2017.

Konsolidimi i programit është bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke ardhur në ditët e sotme në një program të orientuar drejt formimit të studentëve me aftësi profesionale e kompetenca për tu punësuar brenda dhe jashtë vendit, ose për të vijuar studimet e thelluara të ciklit të tretë. Në mendimin e dekanit (*Ev. 2: Mendimi i Dekanit të FSHM*), theksohet fakti se institucioni dhe programi kanë arritur maturimin, duke ofruar standarte dhe cilësitë lartë në përgatitjen e studentëve, por njëkohësisht shprehen se nëçdo rast ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për riakreditim, Universiteti “Aldent” ka aplikuar në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), më 07.10.2022, me shkresë Nr. 47/ prot, për fillimin e procesit të riakreditimit të programit të integruar të ciklit të dytë “Master iShkencave” në “Stomatologji”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UA, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Vergjini Mulo dhe Dr. Manola Kelmendi. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Majlinda Demirneli.

Në datën 26.05.2023 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 22 dhe 23 Qershor 2023 në ambientet e UAL.

Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 30 Qershor 2023. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

## **SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT**

- I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 25 datë 19.05.2017:**
  1. Të gjenden rrugë ose burime të tjera alternative nga projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për financime;
  2. Të rritet mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik me institucione homologe jashtë vendit;
  3. Të krijohen mjedise të hapura sportive në shërbim të studentëve;




## II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

**Për rekomandimin e parë**, GVJ, referuar dokumentave mbështetës dhe diskutimeve të bëra në takimin me drejtuesin e fakultetit, vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Institucioni deklaron se një ndër projektet që është realizuar në bashkëpunim me Universitetin Mjekësor të Sarajevës dhe me 10 universitete të tjera është: “Competency Based Curriculum Reform in Eastern Balkan Dental Schools (Compedent)”, ku u aplikua për një financim 75.000 euro për aparatura bashkëkohore (*Raporti i investimeve të kryera*).

**Për rekomandimin e dytë** GVJ, referuar dokumentave mbështetës, por edhe duke u mbështetur nga deklaratimet e institucionit, rezulton se Univesiteti Aldent është bërë pjesë e projekteve të shkëmbimit të stafit dhe studentëve si: Programi Erasmus+, Programi CEEPUS, etj. Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje me institucione arsimore dhe spitalore në Turqi, Bullgari, Lituani, Ceki, Gjermani. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve të shkëmbimit nga viti 2018-2022, kanë përfituar vetëm për fushën e stomatologjisë: 16 studentë dhe 6 staf akademik. Sipas deklaratimeve, janë në proces aplikimi për kuotat e shpallura 3 studentë dhe 2 staf akademik të programit stomatologji, të cilët priten të kryejnë mobilitetin brenda vitit akademik 2022-2023. Një pjesë e mobiliteteve janë pezulluar gjatë pandemisë duke rifilluar në vitin 22-23. (*Ev.10 Të dhena mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve; Ev.24 Marrëveshjet e bashkëpunimit*). Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**.

**Për rekomandimin e tretë** GVJ, referuar vizitës në institucion, pati mundësinë të verifikojë në vend investimet e bëra në terrene sportive dhe mjediset shlodhëse, rekreative, parking, etj. në funksion të studentëve. Në Kampusin e ri univesitar, studentët mund të shfrytëzojnë përveç ambjenteve të mbyllura (palestrës) edhe ambjentet e hapura sportive (fushë minifutbolli, volejboli dhe basketbolli) et.j (*Ev. 15.2 Relacion infrastrukture*). Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**.

Universiteti “ALDENT”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.12.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 122 / 26 Prot, datë 26.12.2023. Universiteti “ALDENT”, njofton në ASCAL më datë 12.01.2024, me anë të shkresës me Nr.01/1 Prot, datë 10.01.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## Vlerësimi i Programit të Integruar të Studimit Master i Shkencave në “Stomatologji”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

#### Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimi MSc. Stomatologji, është hartuar dhe plotëson kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore, që rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë e module dhe vlerësohet me Kredite ECTS, sipas sistemit vendas dhe atij European të vlerësimit dhe transferimit të tyre.</p> <p>Institucioni ka përcaktuar qartë misionin e tij për këtë program studimi. Qëllimi i hapjes dhe realizimit të programit, si dhe objektivat e tij, janë të qarta dhe të detajuara dhe krijojnë besueshmëri në realizimin e plotë të tyre. Programi i studimit është hartuar dhe po implementohet sipas standarteve dhe kërkesave të arsimit të lartë shqipëtar dhe të atij European dhe synon të jetë i krahasueshëm me të. Programi merr parasysh zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, karakterin kombëtar të arsimit shqiptar dhe ruan e zhvillon vlerat kulturore të kombit tonë. Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë specialistë të aftë e të mirëinformuar në fushën e dentistrisë, që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës, si në shërbimin stomatologjik publik ashtu edhe në atë privat. Studentët në këtë program jo vetëm që marrin vlera të shtuara profesionale, por edukohen me ndjenjën e humanitetit dhe vlerësimin e interesit kombëtar. Programi i studimit synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave dhe traditave kulturore kombëtare dhe të përgatisë profesionistë të ardhshëm, që do t'i çojnë më tej ato.</p> <p><i>Ev 5 : Strategjia e UA;</i></p> <p><i>Ev.4 :Statuti i UAL;</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e këtij institucioni, që synon thellimin dhe perfeksionimin e njohurive të mjekëve stomatologë të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve universitare, në dentistri dhe nëfusha të veçanta të saj si, në dentistri parandaluese dhe konservative, në protetikë, kirurgji orale, ortodonci, dentistri pediatrike etj. Mendojmë se në këtë drejtim institucioni ka eksperiencë të gjatë, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe infrastrukturës.</p> <p><i>Ev.4:Statuti i UAL;</i> <i>Takimi me drejtuesit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është hapur i bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe në këtë mënyrë ai jo vetëm plotëson nevoja e tregut të vendit, por jep një kontribut të vyer edhe në rajon, mbasi ka studentë nga trojet apo shumë studentë të tjerë fëmijë të emigrantëve sidomos nga Greqia. Në këtë drejtim, hapja e këtij programi studimi konsiderohet si një kontribut i madh publik në fushën e dentistrisë në vend dhe në rajon. Aktualisht, UAL ka shprehur në strategjinë aftatgjatë, ofrimin e programeve të reja të studimit bazuar në kërkesat e tregut dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe logjistike. Ky program është në kuadrin e programeve të nivelit të dytë për programet e FSHD dhe përmbush të gjitha pritshmëritë e një programi me objektiv shkencor.</p> <p>Nga ana tjetër, sikundër rezultoi nga takimet e zhvilluara në institucion, kryhen vazhdimisht studime të tregut të punës, në mënyrë që programi t'i përshtatet zhvillimeve të reja të institucionit dhe dentistrisë në tërësi në vendin tonë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, si Statuti, Rregullorja e programit të studimit, Rregullorja e Fakultetit, si dhe Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit, GVJ konstatoi që programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit. Qëllimi dhe objektivat e programit janë në përputhje me dokumentat strategjike, statutin e IAL dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me të gjitha strukturat e organizuara për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, rezulton se</p>

	<p>përbushen objektivat strategjike për zhvillimin institucional të tij. Struktura akademike dhe administrative e Universitetit përbush objektivat e programit të studimit.</p> <p><i>Ev 4: Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Ev 5: Strategjia e UAL;</i></p> <p><i>Ev 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent;</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Misioni i programit është të arsimojë dhe mbështesë studentët, që kur të diplomohen, të kenë cilësi dhe kompetenca profesionale të definuara dhe të përcaktuara, me njohuri të detajuara në disiplinat e lartëcekura, me qëllim që nëpërmjet përgatitjes kompetente teorike dhe praktike, të kontribuohet në avancimin e ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes të shëndetit oral, rehabilitimit të pacientëve dhe njëkohësisht të shëndetit të përgjithshëm dhe mirëqenies të popullatës. Ky program i integruar studimi synon në formimin e studiuesve të rinj në fushat mjekësore, nëpërmjet një programi mësimor-shkencor të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik, si dhe përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm, të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv, në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar dhe trendet globale.</p> <p><i>Ev 5.1 Analizë Alumni;</i></p> <p><i>Ev 5: Strategjia e UAL;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti Aldent ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UAL, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazës përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**



Kriteret	Vlerësimi																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni deonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAL dhe Fakulteti përgjegjës për këtë program studimi, plotëson kriteret e nevojshme të përgjithshme që janë të parashikuara për sa i përket rrejtit formues që lidhet me këtë program studimi. Institucioni vë në dispozicion për mirëfunksionimin e programit të gjitha facilitetet infrastrukturore didaktike dhe burimet materiale laboratorike. UAL plotëson kërkesat dhe standartet më të larta që lidhen me fushën e stomatologjisë. Ky program studimi mbështetet mbi një infrastrukturë të kompletuar, që mundëson formimin teorik sipas standarteve të kërkuara, por dhe një mundësi praktike reale për të kryer intervente të tipeve të ndryshme, por dhe që kanë shkallë vështirësie klinike të ndryshme që varion sipas rastit të paraqitur. Ekzistenca e një numri të madh interventesh operatore që kontrollohen dhe monitorohen vazhdimisht, konsiderohet e mjaftueshme për një formim profesional të arsyeshëm nga ana e studentëve. Vizitat në mjediset e institucionit vërtetojnë se është kryer një numër i konsiderueshëm investimesh në infrastrukturë dhe logjistikën mbështetëse të programit. Sikundër kemi theksuar, institucioni tashmë ka eksperiencën, infrastrukturën dhe personelin akademik i cili ka përvojë disa vjeçare në fushën e Arsimit të lartë në të tre ciklet e studimit në fushën e stomatologjisë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Dentare, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 59 pedagogë, nga të cilët 29 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 30 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1" data-bbox="587 1384 1388 1794"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1384 866 1440" rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2" data-bbox="866 1384 1388 1440">Fakulteti i Shkencave Dentare</th> </tr> <tr> <th data-bbox="866 1440 1118 1496">PAE</th> <th data-bbox="1118 1440 1388 1496">PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1496 866 1552">Prof.Dr</td> <td data-bbox="866 1496 1118 1552">3</td> <td data-bbox="1118 1496 1388 1552">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="587 1552 866 1608">Prof.Asoc</td> <td data-bbox="866 1552 1118 1608">2</td> <td data-bbox="1118 1552 1388 1608">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="587 1608 866 1664">Dr/PhD</td> <td data-bbox="866 1608 1118 1664">7</td> <td data-bbox="1118 1608 1388 1664">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="587 1664 866 1720">Msc</td> <td data-bbox="866 1664 1118 1720">17</td> <td data-bbox="1118 1664 1388 1720">16</td> </tr> <tr> <td data-bbox="587 1720 866 1776"><b>Gjithsej</b></td> <td data-bbox="866 1720 1118 1776"><b>29</b></td> <td data-bbox="1118 1720 1388 1776"><b>30</b></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Dentare		PAE	PAK	Prof.Dr	3	2	Prof.Asoc	2	6	Dr/PhD	7	6	Msc	17	16	<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>	<b>30</b>
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Dentare																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	3	2																			
Prof.Asoc	2	6																			
Dr/PhD	7	6																			
Msc	17	16																			
<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>	<b>30</b>																			

Ndërsa Departamenti i Stomatologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Stomatologjisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2
Prof.Asoc	2	3
Dr/PhD	2	2
SPA	3	1
Msc	4	3
<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>11</b>

*Ev 7.0 Tabelat përmbledhese per Aneks\_RVB Stom;*

*Ev. 7: raporti mbi infrastrukturën;*

*Ev. 7: Tabela përmbledhëse;*

**Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Nga diskutimet me themeluesin e UAL dhe drejtuesit aktualë, u evidentua se institucioni u themelua për formimin e edukimit në fushën e teknikave dentare, e mandej në stomatologji dhe drejtime te tjera të shkencave mjekësore. Kjo do të thotë se programi përputhet plotësisht me drejtimin themelor të institucionit.

Ne e konsiderojmë si pikë të fortë, orientimin e institucionit vetëm në një fushë studimi (fushën mjekësore), çka mundëson plotësimin më të mirë të kërkesave dhe standareve që kanë programet e këtij drejtimi. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti e Shkencave Dentare, Departamenti i Stomatologjisë. Institucioni respekton çdo udhëzim apo akt nënligjor që lidhet me funksionimin e programeve.

**Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Stomatologjisë, i cili ka gjithë kapacitetet akademike dhe logjistike për kryerjen me sukses të programit mësimor, duke bashkëpunuar me klinikën universitare stomatologjike, klinika private,

kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	marrëveshjet me institucione arsimore vendase e të huaja, etj, në funksion të zhvillimit me sukses të programit të studimit. <i>Ev. 7: raporti mbi infrastrukturën;</i> <i>Ev. 7: Tabela përmbledhëse;</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	<b>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UAL mundëson edukim të vazhduar për të gjithë studentët e diplomuar, duke bashkëpunuar me institucione të tjera si p.sh Dental Leader Corsi.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të fakultetit dhe Departamentit të Stomatologjisë. Po ashtu, kjo fushë studimi është fushë kryesore e kërkimit shkencor në UAL.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe	Nga analiza e përmbajtjes së RVB, GVJ konstatohet procedura të shkruara për ndarjen e detyrave mes njësisë përgjegjëse kryesore

<p>mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>(FSHD) dhe asaj bazë (Departamenti i Stomatologjisë). Gjithashtu u konstatuan procedura të shkruara të ndarjes së përgjegjësive mes personelit të angazhuar për programin e studimit, qoftë akademik ashtu edhe jo akademik dhe administrativ. Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë, ku detajohet çdo aspekt i nevojshëm si detyra, role, funksione të personelit, përgjegjësitë e tyre, etj.</p> <p>UAL ka ngritur tre njësi kryesore për të vlerësuar ecurinë e kërkimit shkencor. Ato janë Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike, Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik, Qendra e Promovimit të Shëndetit. Me ndihmën e komisionit të përhershëm të Kërkimit Shkencor, këto koordinojnë veprimtarinë e tyre me atë të Universitetit. Institucioni promovon rezultatet pozitive në fushën e kërkimit shkencor, duke i shpërblyer financiarisht, apo duke i sponsorizuar në pjesëmarrjet e tyre në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime në revista me factor impakti apo botime të librave.</p> <p><i>Ev 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent;</i>  <i>Ev 6.2 Rregullore e FSHD.Alb;</i>  <i>Ev 6.3 Rregullore departamenti;</i>  <i>Ev.7: Tabelat 2;</i>  <i>Ev.4: Statuti i UAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti Aldent së fundmi ka shtuar bashkëpunimet me institucione brenda dhe jashtë vendit. Përveç marrëveshjeve të mëparshme, në këtë periudhë janë shtuar marrëveshje dhe me Universitete të tjera si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Universitetin “Nikolla Koperniku” Poloni;</li> <li>- Universitetin Mjekësor të Plovdivit, Bullgari;</li> <li>- Universitetin Pardubice, Çeki;</li> <li>- Universitetin e Shkencave Mjekësore, Kaunas Lituani;</li> <li>- Auxille Akademie, Essen, Gjermani;</li> <li>- Universitetin e Gracit Austri;</li> <li>- Universitetin e Istinye, Stamboll, Turqi;</li> <li>- Universitetin Acibadem, Stamboll, Turqi;</li> <li>- Universitetin e Ankarasë, Ankara, Turqi;</li> <li>- Universitetin Hacettepe, Ankara, Turqi;</li> </ul>

	<p>Në këtë kuadër, shumë pedagogë të Aldent kanë dhënë mësim si lektorë pranë këtyre Universiteteve, sikurse pedagogë nga universitetet partnere kryesisht nga Universiteti i Chieti-Pescara dhe Aquilas në Itali, pedagogë nga Polonia, Çekia, kanë dhënë cikle leksionesh në Universitetin Aldent, në programe si Farmaci dhe Stomatologji. Ndërkohë, në marrëveshjet e bashkëpunimit që UAL ka lidhur, personeli akademik dhe studentët mund të shfrytëzojnë edhe bibliotekat dhe infrastrukturën që partnerët disponojnë (libra, botime dhe periodikë shkencorë të printuar dhe on line). Lista e institucioneve bashkëpunuese përfshin institucione arsimore brenda dhe jashtë vendin, qendra spitalore universitare, klinika dhe poliklinika dentare private, etj.</p> <p><i>Ev.7:Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Stom.Tabela 5;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universitetit Aldent ka tashmë një rrjet partnerësh dhe bashkëpunorësh, veçanërisht ato që operojnë në fushën e stomatologjisë. Përveç institucioneve arsimore, UAL ka kontrata të rregullta bashkëpunimi prej më shumë se 10 vitesh me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Universitar të Traumës etj. Kjo është e nevojshme vetëm për raste të veçanta, të praktikës profesionale, të cilat janë specifike dhe ofrohen në bashkëpunim me partnerët e institucionit.</p> <p>UAL dokumenton marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Dentare Shqiptare, Shoqatën e Pedodontëve, Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, Shoqërinë "Dental Leader Corsi", Shoqërinë e Sigurimit Albsig Sha, Banka të ndryshme të nivelit të dytë etj. Po ashtu, ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e L'Aquilles në Itali. Shumë pedagogë dhe profesorë të këtij universiteti kanë dhënë leksione në MSc, SPA, apo kanë mbajtur tema në konferenca të ndryshme shkencore.</p> <p>Në RVB dhe gjatë diskutimeve me stafin dhe studentët, u evidentuan edhe shumë bashkëpunime të tjera me Universitete në Lituani, Poloni, Çeki, Turqi, Bullgari, etj. Shumë studentë të stomatologjisë kanë kryer mobilitete me afate të ndryshme kohore, në kuadër të programeve Erasmus, apo në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me universitetet e mësipërme. Në takim me studentët u evidentua se prej kohësh ishte arritur akordi për mobilitet të disa studentëve në Universitetin e Ankarasë në</p>

	<p>Turqi, etj. UAL ka marrëveshje me kompani për prodhimin e materialeve dentare dhe është në prag të finalizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës në Itali, me qëllim që të promovohen aktivitetet në drejtimtë mësimëdhënies dhe kërkimit shkencor, për institucionet respektive. GVJ konsideron në nivel të kënaqshëm bashkëpunimin e UAL me partnerë dhe bashkëpunëtorë brenda dhe jashtë vendit. Për më tepër, GVJ identifikoi rritje të numrit të mobiliteteve në nivel institucional krahasuar me vitet e mëparshme.</p> <p><i>Ev.25.0 Marrëveshje Bashkëpunimi;</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, Zyra e marrëdhënieve me jashtë që organizon dhe formalizon marrëveshjet e bashkëpunimit, dhe harton raporte periodik, me qëllim zbatimin sa me eficient të këtyre bashkëpunimeve. Raporti jep të dhëna mbi studentin/stafin që ka kryer mobilitet, programin e përfshirë, universitetin bashkëpunues, vlerën monetare të përfituar etj.</p> <p><i>Ev.10: Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti Aldent ka eksperiencë shumë vjeçare në arsimin e lartë. Ai ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, pale të treta, institucione brenda dhe jashtë vendit, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të mëtejshëm të tij.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji”, është i organizuar në lëndë sipas kategorisë (A, B, C, D, E), lëndë dhe module, sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”. Plani mësimor është i organizuar në 5 vite akademike, 10 semestra, 30 kredite çdo semestër, 300 kredite gjithë programi. 1 kredit ekuivalentohet me 25 orë mësimore.</p> <p><i>Ev. 7: Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Stom, Tabelat 9; 10;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit, programi synon që studentët të zotërojnë jo vetëm kompetenca të plota profesionale në nivelin e specialistit të fushës, por edhe në nivel të lartë të bashkëpunimit e bashkëveprimit të punës në ekip dhe të raporteve të etikës mjekësore, me pacientët dhe me kolegët e bashkëpunëtorët e tjerë. Të gjitha masat organizative janë marrë që këto synime të realizohen dhe rezultatet e pritshme të këtij programi studimi jo vetëm janë hartuar qartë, por edhe zotërojnë premisat e plotësimit të plotë të tyre. Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen me përgjegjësi të stomatologëve me standardet më të larta profesionale në formimin teoriko-praktik, të aftë që të përballojnë kërkesat gjithmonë në rritje të sistemit tonë mjekësor në përgjithësi dhe atij stomatologjik në veçanti. Emërtimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit përputhen me emërtimin e programit të studimit dhe në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve. Për më tepër, këto gjejnë zbatim edhe në standartet e reja të miratuara në Kodin e Cilësisë 2021. Të gjitha lëndët profesionale në këtë program pasohen nga praktikat laboratorike dhe klinike, duke mundësuar vlerësimin</p>

fushë të specializuar studimi ose profesionale.	kritik të pacientëve nëpërmjet anamnezës,diagnostikimit, trajtimit klinik, duke u bazuar në protokolletë aprovuara.  <i>Ev6.4: Rregullore e programit te studimit Stomatologji;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit mbështetës, programi është organizuar në module e lëndë të cilat janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Lëndët/modulet kanë të përcaktuar ngarkesën në kredite, të konvertuar në orë aktive në auditor ku përfshihen leksionet, seminarët, labororet, detyrat/projektet, praktikat, si dhe orët e vetëpërgatitjes së studentit. Ngarkesa në kredite ECTS për një vit akademik është 60 kredite dhe respekton konvertimin 1 ECTS = 25orë ngarkesë të studentit. Në planin mësimor të gjitha lëndët profesionale karakterizuesesi dentistrisë, endodontia, kirurgjia, ortodoncia, protetika, paradontologjia, pedodontia, kanë në program orë tëveçanta për praktika laboratorike me pacientë në klinikën universitare. Gjithashtu, plani mësimor gjatë tre viteve të fundit të studimeve, parashikon dhe realizimin e 12 krediteve (ECTS) në total, si orë praktike në klinikat/poliklinikat,me të cilat UAL bashkëpunon në funksion të realizimit të praktikës profesionale dhe realizimit të punimit të diplomës. Në përfundim të këtij programi, studentët përballen me një shumëllojshmëri rastesh klinike, nga më të thjeshtat deri tek më komplekset. Realizimi i praktikave klinike në klinikën universitare me pacientë realë të cilët trajtohen falas nga studentët, të udhëhequr nga pedagogu i lëndës, i ka dhënë mundësi studentëve të aftësohen për të punuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të studimit.  <i>Ev. 7: Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Stom,Tabelat 9; 10;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor.	<b>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</b>



<p>Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p><b>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. Studentët aplikojnë në portalin U-Albania dhe përzgjedhja e tyre bëhet në varësi të pikëve që ata fitojnë, duke u bazuar në kriteret të paracaktuara dhe që i bëhen të ditura maturantëve shumë kohë më parë në web-in e Universitetit dhe në portalin U-Albania.</p> <p><i>Ev. 6.4: Rregullore e programit të studimit Stomatologji;</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit MSc në “Stomatologji” është i njëjtë me programe studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtesë, me ato të ofruar nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Albanian University, Universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë”, në masën 70%. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve. Kjo vërtetohet nga numri i lartë i transferimeve në programet e tjera të studimit veçanërisht në Universitetin e Mjekësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, ky program është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve organizohet me 300 ECTS dhe kohëzgjatje normale 5 (pesë) vite akademike me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.</p> <p>Institucioni ka një kodifikim të moduleve sipas një rendi të caktuar për secilin program, në sistemin e brendshëm FX. Ndërkohë, bazuar në Urdhërin e ministrit të arsimit, Kodifikimi i programeve dhe i lëndëve në përbërje të tyre, do të kryhet në nivel kombëtar.</p> <p><i>Ev 12.3: Platforma e menaxhimit online FX Education;</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga vetë institucioni. Bazuar në deklaratimet e drejtuesve, në hartimin apo përmirësimin e vazhdueshëm të tij, ata bazohen në eksperiencat dhe praktikat më të mira brenda dhe jashtë vendit, duke marrë në konsideratë se edhe themeluesi i këtij institucioni është një nga profesionistët më të njohur në vend në fushën e stomatologjisë.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit MSc në Stomatologji organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare të ligjit për arsimin e lartë 80/2015, si dhe akteve të brendshme rregullatore të UAL, Statut, Rregullore etj. Organizimi i programit merr parasysh dhe direktivat evropiane përprofesionet e rregulluara në fushën e mjekësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi																				
<p><b>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</b></p>	<p>Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Departamenti i Stomatologjisë pranë UAL janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia kryesore (FSHD) është e përbërë nga 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Laborantëve Dentarë,</li> <li>2. Departamenti i Stomatologjisë,</li> <li>3. Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik;</li> </ol> <p>Fakulteti i Shkencave Dentare, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 59 pedagogë, nga të cilët 29 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 30 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Dentare</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>7</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>17</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>29</b></td> <td><b>30</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Çdo njësi bazë është e përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MSc në "Stomatologji", Departamenti i Stomatologjisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:</p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Dentare		PAE	PAK	Prof.Dr	3	2	Prof.Asoc	2	6	Dr/PhD	7	6	Msc	17	16	<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>	<b>30</b>
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Dentare																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	3	2																			
Prof.Asoc	2	6																			
Dr/PhD	7	6																			
Msc	17	16																			
<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>	<b>30</b>																			

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	2	1	2	1	2
Prof. Asoc.	1	3	1	3	2	3
Dr./PhD.	2	-	2	2	2	2
SPA	2	1	2	2	3	1
Msc.	3	2	3	3	4	3
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>11</b>

*Ev. 7: Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB Stom*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB, konstatohet se çdo njësi bazë e FSHD ka të paktën një personel ndihmës akademik /administrativ (PNA) të angazhuar. Edhe Departamenti i Stomatologjisë që është njësi bazë që ofron programin e studimit, ka dy PNA të angazhuar. Personeli Ndihmës akademik, PNA pra është në nivel departamenti, dhe ndihmon në koordinimin e detyrave edhe për këtë program studimi.

Orët e zhvilluara në laboratorët mësimorë dhe orët e praktikave klinike, organizohen dhe mbikqyren nga stafi akademik me kohë të plotë i departamentit dhe mbështeten nga strukturat mbështetëse bashkëpunuese.

*Ev. 7: Tabelat përmbledhëse për Aneks\_RVB Stom, tab 1*

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe

Sipas nenit 9, të Rregullores së Fakultetit përcaktohet koordinatori i programit si autoritet drejtues. Detyrat e koordinatorit përcaktohen në nenin 12 të kësaj rregulloreje konkretisht:

- Ndihmon hartimin e kurikulave të disiplinave që mbulon;
- Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e caktuar;
- Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit, dhe informon autoritetet drejtuese;

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>- Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në fund të çdo semestri;</p> <p>Programi i studimit ka koordinatorin e tij, i cili siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Koordinatorin e programit ndjek nga afër ecurinë e studentëve duke monitoruar mbarëvajtjen e procesit mësimor, si në auditor, ashtu edhe në institucionet shëndetësore ku kryhen praktikat e studentëve.</p> <p><i>Ev. 6.2 Rregullore e FSHD.Alb.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Njësia kryesore FSHD dhe njësia bazë DS që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive.</i></p> <p><i>FSHD dhe DS kanë personel ndihmës akademik të angazhuar në ndjekjen e praktikave dhe orëve. Programi i studimit ka një koordinatror, detyrat e të cilit garantojnë mbarëvajtjen e rregullt të aktiviteteve në këtë program.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Plani Mësimor i Programit të Studimit, udhëzime për studentët, etj) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit, disponohen nga Fakulteti i Shkencave Dentare (njësia kryesore) dhe Departamenti i Stomatologjisë (njësia bazë) si edhe elementet kryesore të tyre janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. Në Departament ruhet gjithashtu i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që lidhet me këtë program studimi, që nga momenti i aplikimit / licensimit,</p>

	<p>përditësimeve, syllabuset, ecuria akademike etj. Në arkivën / protokollin e institucionit ruhen versionet zyrtare të programit, vlerësimet dheakreditimet periodike, ecuria akademike eprogramit etj.</p> <p><i>Ev. 6.2 Rregullore e FSHD.Alb;</i> <i>Ev. 6.3 Rregullore departamenti;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Stomatologji, është organizuar sipas kërkesave të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018. Programii studimit janë të organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Lëndë bazë A me 52 kredite= 17.3 %</li> <li>➤ Lëndë Karakterizuese B me 156 kredite = 52%</li> <li>➤ Lëndë ndërdisiplinore integruese C me 43 kredite = 14.3%</li> <li>➤ Lëndë plotësuese D me 27 kredite = 9 %</li> <li>➤ Lëndë përmbyllëse E me 22 kredite =7.4 %</li> </ul> <p>Plani mësimor përmban informacionin në lidhje me orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo lëndë.</p> <p><i>Ev.7.0: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom, tab 10</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi MSc Stomatologji rezulton të jetë një nga programet më të kërkuara të UAL. Nga vlerësimi i kryer i dokumentacionit mbështetës, si edhe takimeve të zhvilluara me studentët, rezulton se në hyrje pranohen maturantë me rezultate të larta. Me synimin e pranimit të kandidatëve cilësorë, rregullorja ka përcaktuar që nota mesatare e kandidatëve është kriter kryesor.</p> <p>Në rregullore janë përcaktuar kriteret e pranimit, si edhe dokumentacioni i nevojshëm i regjistrimit. Kërkesa specifike ka në rregullore dhe propozohen nga njësia bazë dhe aprovohen nga senati akademik në çdo vit akademik. Kriteret e përgjithshme mbështeten në Udhëzimet e ministrisë. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimi i lëndëve të zhvilluara në një IAL/program të mëparshëm studimi, rregullohen me një procedurë që mbështetet në kuadrin ligjor aktual: mbi</p>

	<p>transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve. Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë të mirëinformuar mbi kriteret e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimin e vitit akademik. Informimi i plotë kryhet gjithashtu edhe në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>Ev 6.4: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Ev 12.1.1 Procedura e transferimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor përmban lëndët dhe modulet që zhvillon studentin përgjatë studimeve akademike. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen detajet për detyrimet, praktikën që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe mënyra e rikuperimit apo shlyerjes së mungesave. Çdo program lënde/moduli është shoqëruar me një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që i jep studentit kjo lëndë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Pasqyrimi i plotë i temave që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik.</li> <li>-Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS;</li> <li>-Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre;</li> <li>-Format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën;</li> <li>-Literatura e detyruar e viteve të fundit dhe ajo ndihmëse;</li> </ul> <p>Syllabusi i modulit i prezantohet studentëve që në orën e parë të mësimit për secilin modul. Në rregulloren e studimeve është parashikuar mënyra e frekuentimit të studimeve në këtë cikël dhe arsyet e mundshme të mungesave, si dhe mënyra e rikuperimit të tyre. Referuar kësaj rregulloreje, studentët janë të detyruar të frekuentojnë jo më pak se 70% të leksioneve e të seminareve dhe 100% të orëve laboratorike dhe të praktikave. Rregullorja ka parashikuar edhe shkaqet e ndërprerjes së studimeve, apo të transferimit të tyre në një institucion tjetër brenda apo jashtë vendit.</p> <p><i>Ev 6.4: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Ev 1.0 Syllabus, ALB</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Ndryshimi i programit kryhet në mënyrë të vazhdueshme brenda hapësirës ligjore nën 20%. Përmbajtja e syllabuseve dhe e programit të studimit është në përditësim të vazhdueshëm. Në çdo fillim viti akademik ato rishikohen, dorëzohen dhe arkivohen në departament sipas formatit të aprovuar.</p> <p>Në vitet e fundit, programi nuk ka ndryshime madhore, por ndryshimet janë fokusuar kryesisht në përditësim literature dhe riorganizim të praktikës profesionale e klinike.</p> <p><i>Ev 1.0 Syllabus, ALB</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit MSc Stomatologji është strukturuar dhe organizuar në përputhje me VKM 41, e ndryshuar duke marrë në konsiderate ndarjen e veprimtarive nga A-E, organizimin e syllabuseve sipas formatit të propozuar etj. Përditësimet e programit bëhen në mënyrë të vazhdueshme dhe dokumentohen.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i lëndëve është në përputhje me brendësinë e temave dhe qëllimin. Përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve është e tillë që mundëson kompetenca të studentit duke formuar profesionistë dhe mundësuar punësimin e tyre. Programi mësimor në Msc në Stomatologji është i përbërë nga leksione, seminare, laboratorë dhe praktika. Shpërndarja e veprimtarive formuese dhe zhvillimi i tyre, sigurojnë formimin profesional dhe shkencor të studentëve të gatshëm për tregun e punës ose për vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë.</p>
	<p><i>Ev.7.0: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom, tab 10</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Strukturat bazë të universitetit (departamentet) planifikojnë ngarkesat mësimore të stafit akademik çdo fillim viti, duke patur në konsideratë aktet nënligjore të MASR për ngarkesat mësimore, si dhe vendimin e Senatit akademik. Ngarkesat e planifikuara, si dhe kërkesat për staf përcillen nga departamenti në dekanat dhe aprovohen në Senatin akademik të institucionit. Shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestra gjatë viteve akademike u mundëson studentëve fitimin e njohurive profesionale, në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Ngarkesa mësimore është shpërndarë gjatë gjithë vitit akademik në javë mësimore (15 javë për semestër) dhe në orë për javë (jo më tepër se 25 orë në javë). Kjo shpërndarje është paraqitur në planin mësimor që i bashkëlidhet këtij raporti në evidencat e tij.</p> <p><i>Ev.7.0:Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom, tab 10</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Stomatologji është një program i konsoliduar, pasi ofrohet prej disa vitesh nga institucioni dhe për më tepër ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi. Në këtë kontekst, duke marrë në konsideratë eksperiencën e institucionit, dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe qasjen e stafit dhe studentëve gjatë takimeve, rezulton se programi reflekton një qasje optimale në lidhje me raportin midis veprimtarive formuese dhe teori-praktikë. Shembujt e dhënë të punësimit të studentëve në vende të ndryshme të Europës dhe Amerikës, dëshmonjnë se programi bazohet në një kurrikul e cila reflekton praktikën ndërkombëtare të formimit të stomatologëve. Njohja e plotë e programit dhe punësimi i studentëve në vendet jashtë Shqipërisë, konsiderohet nga GVJ si tregues pozitiv për përmbajtjen dhe formimin e studentëve. Përputhshmëria e programit me programe të ngjashme në këtë rast është e evidente.</p> <p><i>Ev.7.0 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom, tab 9</i></p> <p><i>Vizita në Insitucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e</p>	<p>Reflektimi i raporteve aktuale midis teorisë dhe praktikës ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të vazhdueshme, duke përmirësuar vazhdimisht këtë raport në përputhje me direktivat evropiane, sidhe duke marrë në konsideratë komizën ligjore. GVJ konsideron ndërthurjen midis njohurive formuese teorike dhe</p>

<p>objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>praktike si një nga pikat më të forta të programit. Kjo falë dhe infrastrukturës mbështetëse laboratorike, e cila mundëson praktikë të studentëve qysh në vitin e parë të studimeve. Personeli akademik deklaron se programi mësimor është hartuar dhe përditësohet, duke patur në vëmendje programe të njëjta ose të përafërta të ofruara nga institucione homologe. Duke ruajtur raportet toeri - praktikë për këtë cikël studimi, është e mundur që studentët lehtësisht të kryejnë procese mobiliteti, transferime të kredive apo punësim pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Vizita ne Insitucion, takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Pjesë e programit të studimit janë dhe syllabuset e lëndëve. Syllabuset përmbajnë elementët detyrues të VKM 41, të ndryshuar. Për më tepër, ato përditësohen çdo vit në fillim të tij, duke vendosur në korrespondencë të çdo leksioni literaturën respektive të detyrueshme. Në çdo fillim viti akademik pasirishikohen duke ju referuar udhëzimeve e normativave ligjore në fuqi, syllabuset dorëzohen dhe arkivohen pranë departamentit, të firmosura nga titullari i lëndës.</p> <p><i>Ev.11.0 Syllabus, ALB;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Treguesit kryesorë të programit, si numri i lartë i aplikimeve, përqindja e lartë e punësimit, kënaqshmëria e studentëve e shprehur në pyetësorët e zhvilluar, lehtësia e njohjes jashtë vendit etj, vërtetojnë se programi ka një strukturim të tillë që mundëson formim teoirk, praktik, i cili mundëson jo vetëm aplikim të profesionit dhe punësim, por edhe vijim të mëtejshëm të studimeve apo thellimin e tyre në drejtime të tjera të dentistrisë si kirurgji orale, ortodonci etj. Eksperiencia praktike gjatë viteve të shkollimit jep impakt në punësimin e studentëve.</p> <p><i>Vizita ne Insitucion, takimi me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>UAL ofron prej shumë vitesh programin e studimit Msc. në stomatologji. Nga diskutimet e kryera me drejtuesit e fakultetit, studentët, apo analizimi i pyetësorëve të organizuar nga institucioni, doli se shumë studentë vazhdojnë ciklin e tretë të studimeve ose në Aldent ose dhe në institucione të tjera homologe brënda apo jashtë vendit. Po ashtu, shumë prej tyre janë të punësuar në klinika të ndryshme në vend, apo mbasi kanë marrë</p>

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	liçencën kanë hapur klinikat e tyre. Kjo tregon se programi i ciklit të dytë ofron të gjitha mundësitë, qoftë për të vazhduar studimet në ciklin e tretë, apo për të filluar punën në profesion. <i>Ev. 5.1 Analizë alumni;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit është bazuar në konceptin e formimit profesional e shkencor, për të ofruar aftësim dhe kompetenca. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas KSHK dhe kërkesat e tregut të punës. Programi mundëson avancim në karrierë, ose në vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera, në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar eksperiencës 20 vjeçare, Universiteti Aldent ka mekanizmat e përmirësimit të vazhdueshëm të programit duke u përshtatur me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se pjesa më e madhe personelit akademik të brendshëm ose të jashtëm janë njëkohësisht dhe profesionistë të fushës, të cilët sjellin eksperiencën e tyre gjatë ushtrimit të profesionit, nevojat që dalin nga aplikimi i teknikave dhe teknologjive të reja, apo risitë që sjell shkenca.  Kjo ka shërbyer që gjatë aktiviteteve të ndryshme profesionale, edukimit në vazhdim apo kërkimor shkencor, stafi akademik efektiv dhe studentët alumni shpesh konsultoheshin dhe merrin parasysh mendimet, propozimet dhe sygjerimet e profesionistëve, bashkëpunëtorëve, partnerëve, lidhur me kërkesat e tregut të

	<p>punës. Stafi reflektonte dhe periodikisht i implementonte në ndryshime kurrikulare.</p> <p><i>Ev.7.0:Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Stom, tab 11</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësori anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre.</p> <p>Studentët janë të përfshirë në disa organe të institucionit si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve, NJSBC, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre. Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, prej të cilëve merr informacion në lidhje me punësimin e tyre, kërkesat e tregut të punës duke mundësuar edhe të kuptuarit e nevojës për ndryshim të programit.</p> <p><i>Ev 12.5: Rregullore e Këshillit studentor;</i> <i>Ev 21.3 Pyetësori i Studenteve;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nisur nga fakti që programi i studimit është i fushës së mjekësisë, Departamenti i Stomatologjisë ka përgjegjësinë kryesore në përmirësimin, përditësimin, përshtatjen e programit të studimit.</p> <p>Në bashkëpunim me aktorët brenda institucionit, stafin, studentët diplomuar, apo profesionistët, shoqatat, urdhrin e stomatologut, departamenti kryhen ndryshimet e nevojshme, të cilat ndikojnë në përmirësimin cilësor të programit. P.sh një nga rekomandimet e reflektuara është aplikimi i teknikave dixhitale në stomatologji, ku është mundësuar rishikimi i lëndës, pajisja e laboratorit dhe infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e lëndës. Nga sa më sipër, rezulton se UAL ka lidhje të ngushtë me tregun e punës dhe profesionistët e fushës. Ai zhvillon në rrugë institucionale, komunikim dhe bashkëpunim me institucionet e tjera publike, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë, me qëllim përshtatjen e programit të studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme. Ky tregues konsiderohet nga GVJ mjaft pozitiv, pasi mundëson përditësimin në kohë reale të programit të studimit, duke reflektuar në të nevojën që ka tregu i sotëm në fushën e dentistrisë.</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Universiteti Aldent nxit përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve në procese të ndryshme që zhvillon. Qëllimi është bashkëpunimi në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre, pjesëmarrje në projekte dhe kërkim shkencor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Ky program studimi përgatit specialistë të dentistrisë, që kanë njohuritë e nevojshme mbi bazat e anatomisë e fiziologjisë së organizmit të njeriut, sistemin orofacial dhe strukturat që e plotësojnë në tërësi këtë regjion, por dhe organizmin në tërësi.</p> <p>Ata fitojnë njohuritë e duhura edhe mbi sëmundjet kryesore të kavitetit të gojës, ndryshimet anatomo-patologjike, që ndodhin gjatë çrregullimeve në zhvillim, profilaksinë, diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve, që mund të zhvillohen në gojë, etj. Nga ana tjetër, programi ka orientim drejt kërkimit shkencor, duke mundësuar në këtë mënyrë një ndërthurje midis formimit të avancuar teorik e profesional. Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor është një nga objektivat kryesorë në Universitetin Aldent. Bazuar në deklaratimet gjatë takimeve të zhvilluara, studentët angazhohen me pedagogët respektivë në veprimtari të ndryshme, projekte, si dhe në Konferencën Vjetore Studentore të organizuar nga.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar	<p>Departamenti i stomatologjisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarive akademike. Ai organizon dhe administron procesin mësimor duke respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturën e përdorur, si dhe mënyrën e organizimit të mësimdhënies nisur nga karakteristikat e modulit. Shpërndarja e veprimtarive gjatë vitit akademik merr në konsideratë realizimin e planit mësimor, në mënyrë të tillë që</p>

<p>lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>studentët të kenë një shpërndarje normale të ngarkesës gjatë javës, në mënyrë që të kenë hapësira për organizimin e aktiviteteve të tjera brenda dhe jashtë institucionit.</p> <p><i>Ev 18: Lista e aktiviteteve ekstrakurrikulare;</i></p> <p><i>Ev 6.4 Rregullore e programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Aldent” në organizimin dhe funksionimin e tij, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Shumica e lëndëve dhe moduleve përmbajnë veprimtari si detyra, projekte studimore që zhvillohen si pjesë e programit mësimor. Në program janë përfshirë dhe lëndë si biostatistikë, metodatë kërkimit shkencor, informatikë, të cilat ndihmojnë në përgatitjen e studentëve me aftësi për kryerjen e analizave studimore. Gjithashtu, studime dhe punime shkencore konsiderohen punimet e diplomave dhe mikrotezave. Organizimi i përvitshëm i konferencave shkencore studentore nxit pjesëmarrjen e tyre me tema të punuara nga ata, udhëhequr nga pedagogët e lëndëve. Institucioni nxit studentët të jenë pjesë e veprimtarive kombëtare të fushës së mjekësisë, aktiviteteve dhe konferencave që zhvillohen nga institucione të tjera.</p> <p><i>Ev.16: Libri i abstrakteve të konferencës shkencore UAL, <a href="http://aldent.conference.org">aldent.conference.org</a>;</i></p> <p><i>Ev.13: Aktivitet Shkencore UAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik, u konstatua se Institucioni mbështet dhe motivon të gjithë anëtarët e stafit akademik për pjesëmarrje aktive në projekte të ndryshme kërkimore shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë. Universiteti Aldent ka si njësi bazë mësimore-shkencore departamentet, të cilat përfshijnë fusha të caktuara studimi dhe kërkimi në përputhje me programet e studimit që ofrojnë. Përveç departamenteve si njësi bazë, që kanë në fokus të tyre kërkimin shkencor, UAL ka Qendrën Kërkimore Farmakoterapeutike (QKF), pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, apo njësi bazë që kanë prioritet formimin e vazhduar, shërbimet klinike, Qendrën e Formimit dhe Shërbimit Klinik dhe Qendrën e Promovimit të Shëndetit.</p> <p>Departamenti në koordinim me këto qendra organizon aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim për profesionet shëndetësore</p>

	<p>dhe leksione me lektorë të huaj për stafin dhe studentët. Universiteti ka buxhet të programuar me zë të veçantë financiar për aktivitet kërkimore e shkencore, trajnime si të stafit dhe studentëve, për aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Mbështetja është edhe individuale, në varësi të kërkesave dhe angazhimit të stafit dhe studentëve në aktivitete e projekte të ndryshme.</p> <p><i>Ev.14: MBESHTETJE FINANCIARE PER STAFIN</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit garanton përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunorëve në projekte dhe kërkim shkencor. Në program janë përfshirë edhe lëndë si biostatistikë, metoda të kërkimit shkencor, informatikë, të cilat ndihmojnë në përgatitjen e studentëve me aftësi për kryerjen e analizave studimore. Gjithashtu, studime dhe punime shkencore konsiderohen punimet e diplomave dhe mikrotezave. Organizimi i përvitshëm i konferencave shkencore studentore nxit pjesëmarrjen e tyre me tema të punuara nga ata, udhëhequr nga pedagogët e lëndëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se aktiviteti kërkimor zhvillohet edhe në bashkëpunim me institucione dhe partnerë të jashtëm të institucionit. Departamentet dhe njësitë kërkimore brenda universitetit, si Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik, apo Qendra e Promovimit të Shëndetit, kanë në fokus realizimin e studimeve, analizave, projekteve, në bashkëpunim me partnerët jashtë institucionit.</p> <p><i>Pavarësisht angazhimit individual në aktivitete shkencore e projekte, <u>GVJ konstaton se në nivel institucional kërkohet rritje e</u></i></p>

	<p><u>angazhimit të personelit për të siguruar projekte studimore në fushën e programit të studimit.</u></p> <p><i>Ev 22 : Marrëveshjet, Ev 18.1 Aktivitete të QPSH;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Laboratorët në Universitetin Aldent janë një nga investimet më të mëdha dhe asetet më të vlefshme në shërbim të plotë të studentëve dhe stafit akademik, për kryerjen e analizave, studimeve e projekteve me karakter kërkimor shkencor, kjo u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Laboratorët dentarë të stomatologjisë me 42 fantoma, janë të kompletuara me pajisje, materiale dhe përbëjnë një bazë të konsiderueshme në funksion të projekteve kërkimore të studentëve. Personeli i angazhuar në 11 salla klinike, me 32 unite dentare ,motivon studentët të kryejnë ndërhyrje të ndryshme si pastrim gurëzash, mbushje të gradave të ndryshme, ekstraksione dentare, implante dentare, të gjithë gamën e punimeve protetike si proteza totale dhe parciale të lëvizshme, ura fikse. Po ashtu realizohen shumë aparate ortodontike fikse dhe të lëvizshme. Laboratorët e institucionit shfrytëzohen plotësisht për trajtime të pacientëve nga terapia, protetika, kirurgjia, më qëllim aftësimin e studentëve dhe realizimin e kërkimit shkencor nga studentët dhe stafi akademik. Falë marrëveshjeve institucionale sigurohen pafund mundësi trajnimi, hulumtimi më qëllim rritjen akademike dhe profesionale.</p> <p><i>15.2: Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Ev 15: Përshkrimi i laboratorëve;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara, studentët u shprehën se ata marrin pjesë në aktivitete që zhvillon institucioni sikundër është konferenca vjetore e studentëve. Institucioni zhvillon leksione, seminare të hapura, ose është bashkëorganizator në shkollat verore e dimërore, konferencat mjekësore etj. UAL dhe fakultetet e tij, organizojnë periodikisht konferenca shkencore kombëtare ose ndërkombëtare, punimet e të cilave janë të finalizuara dhe me botime në revista/buletine shkencore me bord editorial apo proceedings etj. Gjatë këtyre konferencave ofrohet mundësia që stafi akademik dhe studentët të prezantojnë punime shkencore mbi fushat kërkimore përkatëse. Një nga eventet që zhvillohet në</p>



	<p>mënyrë periodike është Konferenca ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore.</p> <p><i>Ev.16 : Libri i abstrakteve konferenca studentore;</i></p> <p><i>Ev.14: Mbështetja financiare;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>UAL ka në fokus të veçantë monitorimin, studimin dhe vlerësimin e tregut të punës, trendet rajonale e më gjerë. Nëpërmjet një sërë indikatorësh dhe mekanizmash, UAL studjon dhe vlerëson tregun e punës. UAL jep një kontribut të rëndësishëm për të ndihmuar studentët që duan të punësohen jashtë vendit, pasi fushat që ofrohen janë shumë të kërkuara. Kjo ndihmë është e gjithanëshme dhe përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekomandimin e studentëve në kompani serioze rekrutimi, për të mësuar gjuhën e huaj dhe për të bërë trajnime shtesë dhe plotësim dokumentacioni;</li> <li>• Dhënien e gjithë dokumentacionit të kërkuar shpejt, falas, shpesh dhe në gjuhë të huaj;</li> <li>• Mbështetja nga stafi me rekomandime në rastet kur kërkohet nga studentët;</li> <li>• Përgjigje e shpejtë dhe korrekte në rastet kur kërkohen verifikime apo plane mësimore nga universitete apo institucione të huaja;</li> </ul> <p>Universiteti ndjek një politikë bashkëpunimi edhe me konkurentët e tij në treg, qofshin publikë apo privatë. GVJ identifikon si praktikë të mirë kombinime veprimtarive formuese, si mësimi teorik në auditor, studimi individual dhe praktika laboratorike e klinike, të cilat bëjnë të mundur paisjen e studentëve me njohuri të thelluara dhe aftësitë e duhura profesionale dhe shkencore, duke i bërë ata konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Këtë e dëshmon dhe përqindja e lartë e punësimit në nivel programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për</p>	<p>Universiteti bashkëpunon edhe me shoqatat dhe Urdhrat e profesionistëve shëndetësorë, ku mund të përmendim Urdhërin e Infermierit, Urdhërin e Stomatologut, Urdhërin e Farmacistit, si dhe me shoqata të ndryshme si shoqata Shqiptare e Fizioterapisë, Shoqata e Stomatologëve, Shoqata e Kirurgjisë Maksilofaciale, Shoqata e Ortodoncisë etj. Këto bashkëpunime mundësojnë</p>

kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	sjelljen e ekspertizës, rekomandimeve, shembujve dhe praktikave më të mira në funksion të programit të studimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian ( <i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	<p>Kohëzgjatja e studimeve dhe numri i krediteve në këtë program janë konform Ligjit për Arsimin e lartë 80/2015, Ligjit për Profesionet e Rregulluara, si dhe gjithë akteve të tjera ligjore në fuqi. Konkretisht, Programi aktual i MScnë Stomatologji në Universitetin Aldent zgjat 5 vite akademike dhe ka 300 kredite ECTS.</p> <p>Programi ka marrë në konsideratë Deklaratën e Bolonjës, Direktivën 2005/36/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, duke u përshtatur njëkohësisht me programe të ngjashme të Universiteteve italiane, veçanërisht me ata që UAL ka marrëdhënie, profesorë të cilëve japin mësim në këtë program, si p.sh Universitetin e Kietit, Universitetin e Aquilës në Itali, etj. Eksperiencat europiane janë marrë parasysh në hartimin e këtij programi studimi. Edhe në takimet me drejtuesit, u argumentua gjërësisht përputhshmëria e programit me direktivën evropiane.</p> <p><i>Ev 6.4 Rregullore e programit te studimit;</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAL dhe fakultetet e tij, organizojnë periodikisht konferenca shkencore kombëtare ose ndërkombëtare, punimet e të cilave janë të finalizuara dhe me botime në revista/buletine shkencore me bord editorial apo proceedings etj. Gjatë këtyre konferencave ofrohet mundësia që stafi akademik dhe studentët të prezantojnë punime shkencore mbi fushat kërkimore përkatëse. Një nga eventet që zhvillohet në mënyrë periodike, është Konferenca ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore. Organizimi i përvitshëm i konferencave shkencore studentore nxit pjesëmarrjen e tyre me tema të punuara nga ata dhe udhëhequr nga pedagogët e lëndëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia është një nga veprimtaritë e konsoliduara në Universitetin Aldent. Si në dokumentacionin mbështetës të raportit, edhe në takimet në institucion, me drejtuesit, personelin akademik, studentët u deklaruan se aktualisht institucioni aplikon metodat më inovative të mësimdhënies në fushën e shkencave mjekësore.</p> <p>Ashtu sikurse deklarohet në RVB dhe nga takimi me studentët, realizimi i orëve të teorisë, laboratorit apo edhe detyrave të kursit në ndërthurje me njëra tjetrën, bëjnë të mundur përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies, element ky i cili ndikon në rritjen e nivelit të mësimdhënies në këtë program studimi. Studentët përfshihen në paraqitjen, hartimin dhe prezantimin e detyrave të kursit, leksione të hapura, që në vitin e parë të programit të studimit, gjë e cila i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë e shprehjes dhe argumentimit të rezultateve. Me kampusin e ri universitar, mjediset në funksion të mësimdhënies janë me hapësira të bollshme, kushte komode, infrastrukturë logjistike të përditësuar, ç'ka mundëson një mësimdhënie në kushtet optimale. Nga takimi me studentët, rezulton se vlerësimi për kapacitet që institucioni ofron, është maksimal. Ky vlerësim rezulton edhe në raportin e rezultateve të pyetësorit të zhvilluar për vitin 2023.</p>
	<i>Vizita në institucion;</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia vlerësohet nëpërmjet cilësisë së leksioneve, aplikimit të metodave interaktive me studentët, marrëdhënieve me studentët gjatë orës së mësimi, serioziteti dhe afësia në udhëheqjen e laboratoreve dhe praktikave mësimore, udhëheqjen e temave të diplomës etj. Këto të dhëna merren nga disa burime si psh: pyetësorët në mënyrë elektronike dhe të shkruar, nga kontaktet e drejtpërdrejta të drejtuesve të institucionit me qeverinë studentore apo vetë studentët, nga rezultatet e studentëve në lëndët përkatëse etj. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një eksperiencë të gjatë akademike dhe përshtat metodologjinë e mësimdhënies ndaj diversitetit të studentëve në auditor. Institucioni organizon trjanimet të ndryshme ku përfshihen ato me tematika në mësimdhënie, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentët pas vitit të parë përfshihen nga stafi në punime të ndryshme, u kërkohet të japin mendime etj.</p> <p><i>Ev 19. Trajnimet mbi mesimdhënien per stafin UAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti Aldent për shkak të specifikës dhe natyrës së programeve të studimit që ofron, ka adaptuar dhe përdor metoda të ndryshme në mësimdhënie. Avancimi i teknologjisë ka krijuar mundësinë e futjes së këtyre metodave të reja, që përfshijnë formate të mësuarit dhe të dhënies së njohurive me ndihmën e teknologjisë, edukimin e vazhduar dhe atë në distancë. Mësimdhënia përfshin përshtatjen dhe zbatimin e praktikave akademike më të përparuara, të cilat bazohen në ndërthurjen e teorisë me praktikën dhe teknologjisë me mësimdhënien. Këtyre metodave i bashkangjitet një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si edhe ndërthurja e shpjegimit teorik me demonstrime konkrete dhe aplikim direkt të procedurave diagnostikuese dhe terapeutike gjatë praktikave klinike. Stafi akademik i angazhuar në programet e ciklit të parë ka nivelin e kualifikimit akademik të parashikuar në Ligjin e arsimit të lartë dhe është kompetent në zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Megjithatë, ai mbështetet me infrastrukturën e duhur, trajnimet e ndryshme mbi teknologjitë e reja, si p.sh platformën e mësimdhënies on</p>

	<p>line UAL – LMS, së bashku me hapësirën virtuale, të cilën pedagogët e bëjnë aktive me titullin e lëndës dhe publikojnë vetëm për studentët e grupit të tyre materiale didaktike, si përmbledhje të leksioneve në ppt apo pdf, linqe, foto, video mësimore, afatet dhe detyrimet e studentit për këtë lëndë/modul. Studentët kanë akses në platformë nëpërmjet adresave të tyre personale të universitetit nga pedagogu administrator i lëndës, ose duke e shpërndarë kodin e bashkëlidhjes gjatë orëve të leksionit në auditor.</p> <p><i>Ev. 20: Print screen Platforma online ual.iqe.al;</i></p> <p><i>Vizita në UAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë të shumta dhe në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese, por edhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies/mësimnxënies.</p> <p>Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe specific, përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka nivelin e kualifikimit akademik të parashikuar në ligjin e arsimit të lartë dhe është kompetent në zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</p> <p><i>Ev 6.4 Rregullore e programit te studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Referuar RVB-së por edhe takimeve ne UAL, u konstatua se monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme cilësia e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies, duke marrë mendimet e studentëve në mënyrë verbale dhe joverbale përmes pyetjes direkte gjatë orëve mësimore, përmes takimeve me tutoriatin apo edhe nga plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve, ku një rëndësi të veçantë kanë edhe pyetjet rreth opinioneve mbi metodat e mësimdhënies, impakti i tyre në rezultatet e pritshme të</p>

	<p>studentëve, si edhe sygjerimet respektive. Nëpërmjet pyetësorit studenti jep një feedback lidhur me mendimin e tyre mbi zhvillimin e procesit mësimor, ku mendimet dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë.</p> <p><i>Ev. 21.3. Pyetësor i studentëve;</i></p> <p><i>Takimi me studentët;</i></p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka si parim vlerësimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie, duke promovuar shembuj të praktikave më të mira, nxitjen e vazhdimësisë së tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit.</p> <p><i>Ev. 21.3. Pyetësor i studentëve;</i></p> <p><i>Ev 22.4.1 Formulari i performances akademike;</i></p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti aldent garanton procesin e mësimdhënies dhe aftësimin profesional e shkencor pasi disponon infrastrukturë dhe logjistikë moderne. Kjo infrastrukturë mundëson aplikimin e me metodave dhe praktikave më të mira, që sigurojnë arritjen e rezultateve. UAL vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre dhe të partnerëve</i></p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>UAL ka një bazë rregullatore të mirëorganizuar në lidhje me mënyrat dhe testimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Sikurse përcaktohet në RVB, studentët në UAL përveç detyrimeve akademike që kanë gjatë procesit mësimor, përfshihen në shumë aktivitete të tjera kulturore, me qëllim motivimin për të qenë jo vetëm profesionistë por edhe qytetarë të denjë dhe t'i shërbejnë komunitetit. Institucioni në bashkëpunim me këshillin studentor organizon vazhdimisht evente shkencore, sociale, kulturore, sportive, me një përfshirje sa më të gjerë të studentëve në organizim dhe në pjesëmarrje.</p> <p><i>Ev 6.4 Rregullore e programit te studimit Stomatologji Alb;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në takimin e organizuar me studentët e programit, u konstatua se në fillimin e çdo lënde apo moduli, ata informohen nga pedagogu i lëndës, për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Zakonisht ora e parë e çdo lënde rezervohet për prezantimin e detajuar nga ana e titullarit të lëndës të përmbajtjes së lëndës / modulit dhe detyrimeve të studentëve. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në platformën e menaxhimit të mësimin dhe nëpërmjet emailit institucional me të cilin ishte i pajisur çdo student.</p> <p><i>Ev 11 : Syllabuset e moduleve;</i></p> <p><i>Ev.20 Platforma online, print screen;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në</p>	<p>Bazuar në aktet rregullatore të institucionit, metodat e përdorura për testimin e aftësive të studentëve janë: provimi me shkrim, pyetje me gojë, detyra kursi, demonstrim teknikash, vlerësimi me shkrim i udhëheqësit të praktikave, provimi me shkrim formues</p>

<p>forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>ose temë diplome. Sikurse përmendet në RVB, në funksion të testimit dhe vlerësimit të njohurive, në rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve, përcaktohen rregullat e dhënies së provimeve, vëzhgimit, korigjimit të provimeve, mënyra e vlerësimit, komunikimi dhe konfidencialiteti i vlerësimit, ashtu edhe mënyra e ankimimit.</p> <p><i>Ev 11 : Syllabuset e moduleve;</i> <i>Ev 6.4 Rregullore e programit të studimit Stomatologji.Alb;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL në bashkëpunim me këshillin studentor organizon vazhdimisht evente shkencore, sociale, kulturore, sportive, me një përfshirje sa më të gjerë të studentëve në organizim dhe në pjesëmarrje. Programet vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në platformën e menaxhimit të mësimin dhe nëpërmjet emailit institucional me të cilin janë pajisur çdo student.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, u deklarua se vlerësimi i studentëve është i vazhdueshëm. Nëpërmjet platformës së mësimdhënies, apo në mënyrë individuale, pedagogët mbajnë rekorde mbi ecurinë e studentëve. Këto forma me elementë të shumëfishtë dhe pesha specifike e secilit prej tyre është përcaktuar në syllabuset e lëndëve, duke mundësuar vlerësimin sa më të mirë nga ana e pedagogëve dhe në të njëjtën kohë nxit studentët për përgatitje më sistematike gjatë gjithë semestrit, duke motivuar vëmendjen e tyre në të gjithë elementët e vlerësimit. Në varësi të tipologjisë së lëndës, shtrirjes së tij në</p>



	<p>një vit akademik dhe krediteve, vlerësimi ndahet në disa zëra si psh: pikë për aktivizimin gjatë vitit, kolokiume, praktika laboratorike, etj.</p> <p><i>Ev 11 : Syllabuset e moduleve;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAL ka në zbatim mënyra të ndryshme për të shmangur forma të ndryshme abuzimi dhe për të rritur transparencën. Institucioni ka sistem elektronik testimi dhe vlerësimi për testin e hyrjes së studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, gjatë pandemisë, institucioni ka përdorur testimin on-line nëpërmjet platformës. Për testimin e lëndëve, provimet kryhen në salla të mbikqyrura, që redukton mundësinë e kopjimit, dhe rezultatet jepen brenda 3 ditëve nga kryeja e provimit.</p> <p><i>Ev 20. Print screen platforma online _UAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet nga pedagogu lektor, nën mbikqyrjen e titullarit të lëndës dhe teza e përgatitur prej tij firmoset nga Drejtuesi i Departamentit. Përmbajtja e tezës bazohet në syllabusin e lëndës të dhënë gjatë viti akademik dhe përmban gjithë elementët informues të kërkuara nga baza ligjore në fuqi. Në këtë pikëzim bën pjesë vlerësimi për pjesën teorike, praktike laboratorike, kolokium, si edhe për provimin përfundimtar. <i>Ev.12.1, Procedurat e provimeve;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Personeli akademik ju mundëson studentëve që të marrin feedback për performancën e tyre gjatë provimit. Në provimet me gojë, këto këshilla jepen direkt. Në provimet me shkrim, këshillat jepen ndaj studentëve të cilët dëshirojnë të shikojnë tezën dhe vlerësimin që kanë marrë. Shënimet vendosen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për studentin; këto së bashku edhe me komentet verbale kanë si qëllim nxitjen dhe motivimin e studentit në përmirësim të rezultateve të të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën,</p>	<p>Njësia përgjegjëse ka përgatitur rregullore për përgatitjen e temës së diplomës, si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve, të cilat shmangin mundësinë e plagjiaturës dhe të kopjimit. Edhe në syllabuset e lëndëve shprehet qartë kërkesa për integritet akademik dhe shmangie të plagjiaturës. Provimet kryhen në</p>

<p>kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>salla me kamera me qëllim shmangien e kopjimit nga studentët. Provimi organizohet në auditorë të bollshëm me një numër të kufizuar studentësh, duke siguruar një hapësirë midis dy tavoletave.</p> <p><i>Ev 8.1 Modaliteti i diplomës;</i> <i>Ev.12.1 : Procedura e provimeve;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e testimeve apo vlerësimit të kompetencave profesionale bëhen bazuar në meritën e studentit dhe sipas rregullore së institucionit, e rregullore së sekretarisë mësimore; rezultatet e provimeve jepen brënda 7 ditëve nga kryerja e provimit. Një ditë mbas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe printohet procesverbali, i cili firmoset nga lektori dhe depozitohet në sekretari dhe department.</p> <p><i>Ev.6.1 Rregullore e Universitetit Aldent;</i> <i>Ev 12.2: Rregullore e sekretarisë;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas rregullore së institucionit, garantohej e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin; pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. Në rast të paqartësive, studenti ka të drejtë të shikojë provimin në prezencën e pedagogut. Për sqarime të mëtejshme studenti i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse. Institucioni ka të sanksionuar në kuadrin rregullator të tij, që çdo kërkesë, ankimim, të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Në pamundësi të zgjidhjes së ankesës, Drejtuesi i Departamentit vë në dijeni Dekanin, i cili ngrë një komision ad hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit, duke vlerësuar tezën e provimit me shkrim. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të studentit. Ndryshimi i notës pasqyrohet në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni ad hoc dhe i bashkangjitet procesverbalit të mëparshëm.</p> <p><i>Ev. 6.1: Rregullore e Universitetit Aldent;</i> <i>Takimi me studentët;</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>Ev. 6.1: Rregullore e Universitetit Aldent;</i> <i>Takimi me studentët;</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL disponon aktet rregullore, procedura udhëzues për testimin, vlerësimine njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</i></p>

	<i>dhe shkencore. Vlerësimet janë transparente dhe bazuar në meritë dhe studentëve u mundësohet e drejta e apelimit. Institucioni ndalon kopjimin, plagjiaturën dhe promovon arritjet e studentëve</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit ka të përfshirë lëndë bashkëkohore të fushës së dentistrisë të cilat garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Lëndët e përfshira në këtë program studimi janë lëndë të cilat formojnë me kompetenca një të diplomuar në fushën stomatologjisë. Njohuritë e thelluara në lëndët bazë dhe karakterizuese mundësojnë punimin e mikrotezës, nga puna individuale e studentit diplomant nën mbikqyrjen e udhëheqësit shkencor. <i>Ev 7.0: Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB Stom;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në programin e studimit Msc Stomatologji janë përfshirë edhe syllabuset e lëndëve të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta, të nevojshme dhe të rëndësishme për të krijuar një formim bashkëkohor si: informatika bazë dhe e aplikuar; statistika; shkencat humane (psikologji dhe sociologji) dhe komunikimi (anglisht bazë dhe profesionale, art komunikimi, etj.  Me anë të këtyre moduleve studenti njeh mënyrën e funksionimit të shërbimeve të cilat do të jenë të rëndësishme gjatë proceseve të punës, apo edhe realizimit të kërkimit shkencor gjatë dhe pas diplomimit në këtë program studimi. <i>7.0: Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB Stom;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të	Çdo titullar lënde ka përcaktuar në syllabusin e lëndës kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë në përfundim të lëndës.

<p>paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Pedagogu i lëndës, gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, praktikave mësimore, orienton studentët për çështjet më të rëndësishme, si dhe detyrimet përmbyllëse që ai ka kundrejt plotësimit të programit. Detyrimet e studentit janë: pjesëmarrja në leksione, seminare, praktika, kryerja e detyrave të kursit, provimeve. Plotësimi i detyrimeve, bën të mundur që studenti të fitojë kompetencat dhe aftësitë përkatëse në përfundim të lëndës. Në këtë program studimi është sygjëruar që në lëndët karakterizuese profesionale gjatë përpilimit të tezës, pedagogu të ketë në konsideratë pyetjet konkrete me raste klinike të cilat studenti duhet t'i analizojë.</p> <p><i>Ev. 11.0 Syllabus, ALB;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Metodologjia e ndjekur gjatë zhvillimit të programit të studimit, mundëson që mesimdhënia të bazohet në kompetenca në mënyrë që studentët të përdorin dhe zhvillojnë njohuritë e marra nëpërmjet aplikimit të tyre duke përdorur laboratorët dhe aplikimit gjatë praktikës profesionale. Rol të rëndësishëm në formimin e studentit kanë dhe praktikat që realizohen në klinika private gjatë orëve të praktikës profesionale, ku studentët marrin eksperiencën dhe i ndajnë mes tyre gjatë prezantimeve dhe projekteve të realizuara në kuadër të procesit mësimor.</p> <p><i>7.0: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, institucioni përgatit planin vjetor të aktiviteteve shkencore, i cili miratohet nga Senati Akademik dhe përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik efektiv dhe</p>

hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	me kontratë, ku përfshihen leksione të hapura, prezantimi i studimeve shkencore dhe njohja me të rejtat më të fundit të shkencës. Këto organizime bëhen sipas një kalendari të përcaktuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. <i>Ev.19 : Trajnime stafi UAL;</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Sikurse përmendet edhe në RVB, studentët e FSHD prej vitesh marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit. Është vënë re një rritje e cilësisë së punimeve të studentëve nga viti në vit dhe e pjesëmarrjeve aktive në konferencat mjekësore të organizuara nga UAL, Fakulteti i Mjekësisë, etj. <i>Ev.16 : Libri i abstrakteve konferenca studentore;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Përmbajtja e programit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore në fushën e dentistrisë. UAL nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara, metodat e avancuara në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në procedurën e diplomimit përcaktohet mbrojtja e diplomës sipas krediteve të përcaktuara në planin mësimor. Sipas planit mësimor diploma mbrohet me temë diplome. Departamenti ka përgatitur një udhëzues për hartimin e punimit të temës së diplomës. Ky instrument ju bëhet me dije studentëve që në fillim të vitit të pestë akademik dhe përmban informacion të hollësishëm rreth procesit në fjalë.  <i>Ev 8.1: Modaliteti i diplomës;</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Temat e Diplomës propozohen nga të gjithë mësimdhënësit. Çdo mësimdhënës duhet të propozoj deri në tetë tema për punimin e diplomës. Drejtuesit e departamenteve duhet të paraqesin propozimin e temave të Diplomës nga stafi akademik i katedrës përkatëse në fillim të çdo viti akademik dhe sipas kërkesës së koordinatorit të programit edhe në periudha të tjera. Studentët e programit të studimit fillojnë procedurat për identifikimin e temës dhe mentorit potencial në vitin e fundit të studimeve. Kohëzgjatja e përfundimit të temës së diplomës duhet të jetë jo më shumë se 3 muaj nga data e zyrtarizimit të temës. Studentët në vitin e parë zhvillojnë modulën e Biostatistikës, më pas në vitin e katërt Metodën e kërkimit shkencor, që u japin njohuritë bazë për realizimin e një projekti studimor kërkimor shkencor.</p> <p><i>Ev 8.1: Modaliteti i diplomës;</i></p> <p><i>Takimi me studentët;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar RVB, në vlerësimin përfundimtar komisioni merr në konsideratë arritjet e studentit, mënyrën dhe cilësinë e prezantimit të mikrotezës, cilësinë e materialit të diplomës së dorëzuar në hardcopy, mendimin e pedagogut udhëheqës, si edhe performancën e studentit në pesë vitet akademike, duke i dhënë një peshë dhe rëndësi specifike lëndëve të formimit profesional. Komisioni prej pesë anëtarësh i ngritur nga Dekani i fakultetit, duke vlerësuar së bashku këto elementë arrin në një konkluzion final mbi vlerësimin e studentit. <i>RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai</p>	<p>Udhëzuesi për hartimin e punimit të temës së diplomës, përcakton qartë rolin e mentorit në përcaktimin e temës, përgatitjen e temës, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, shkrimin e punimit, strukturën e temës. Mentori i studentit në fund jep pëlqimin nëse tema është në përputhje me kriteret e vendosura në udhëzuesin e hartimit dhe punimit të diplomës.</p> <p><i>Ev.8.3: Formular aplikimi për temën e diplomës;</i></p>

<p>garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti dhe Udhëheqësi i temës, bazuar në “Rregulloren e studimit në Master i Shkencave në Stomatologji” dhe “rregulloren e tutoriatit”, asistojnë studentin për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij, bazuar në temën e përzgjedhur apo të dhënat që nevojiten.</p> <p><i>EV 6.4: Rregullore e programit të studimit Stomatologji;</i> <i>EV 12.6: Rregullore e tutoriatit;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimit me studentët, pas dorëzimit të formatit fizik në formë libri të shtypur dhe në mënyrë elektronike, studentit prezantohet një përmbledhje të diplomës para komisionit të caktuar më parë, i cili në përfundim e vlerëson atë me notë.</p> <p><i>RVB; Takimi me studentët;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë procedurën që në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Ev 8.1: Modaliteti i diplomës;</i> <i>Ev 8.1.1: Format Diplome dhe Supplement i miratuar;</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin e përcaktuar, i cili u verifikua në sekretari gjatë vizitës. Informacioni ruhet në regjistrat e furnizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni disponon mekanizma të organizimit, mbështetjes dhe vlerësimit të studentëve në shlyerjen e detyrimeve përmbledhëse. Udhëzuesi për hartimin e punimit të temës së diplomës, përcakton qartë rolin e mentorit në përcaktimin e temës, përgatitjen e temës, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, shkrimin e punimit, strukturën e temës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky program është master shkencor, megjithatë, Departamenti përgjegjës për realizimin e programit të studimit ka vendosur në dispozicion të studentëve dhe stafit pedagogjik salla leksioni me projektorë për dhënien e njohurive teorike, një laborator stomatologjik të mirë pajisur për kryerjen e laboratorëve; klinika stomatologjike është përbërë me 11 salla terapie, endodontie, protetike, kirurgjie, paradontologjie, etj, të kompletuara me të gjitha aparaturat e nevojshme si unite dentare, autoklava, lazer kirurgjikal, mikroskop endodontik, mikromotorr endodontik, piezo surgery, centrifugë, etj. Këto përbëjnë një bazë të konsiderueshme për realizimin e programit të studimit. Gjithashtu, institucioni ka lidhur një sërë marrëveshje bashkëpunimi, të përshtatshme për kryerjen e praktikës laboratorike dhe praktikës profesionale.  <i>Ev. 15.1: Përshkrimi i laboratoreve;</i> <i>Ev. 25.0: Marrëveshje Bashkëpunimi;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe	Për realizimin e praktikave profesionale, institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione arsimore të huaja dhe vendase. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është përfitimi më i mirë i njohurive dhe kompetencave



stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitim të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	profesionale, njohja me mënyrën e organizimit të punës në klinika universitare të vendeve të huaja, etj. <i>Ev. 25 :Marërvëshje Bashkëpunimi;</i>			
<b>Kriteri 3. Praktik</b> at profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Studentët i zhvillojnë praktikat profesionale dhe e dokumentojnë me relacion që behet nga studenti dhe me vlerësim nga mjeku që e ka ndjekur praktikën. Në këtë dokument pasqyrohen orët praktike të zhvilluara, në fund të praktikave, orët praktike konvertohen në numër kreditesh.  <i>Ev.6.5.1 Leje praktike në klinika dentare;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAL ka vendosur në dispozicion të studentëve dhe stafit pedagogjik salla leksioni me projektorë për dhënien e njohurive teorike, një laborator stomatologjik të mirë pajisur për kryerjen e laboratorëve; klinika stomatologjike është e përbërë me 11 salla terapie, endodontie, protetike, kirurgjie, paradontologjie, etj, që mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale e klinike në funksion të programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi																																																															
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga pedagogë me eksperiencë pedagogjike dhe klinike dhe përgjithësisht me kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar edhe gjatë vizitës në institucion, janë angazhuar staf akademik për pesë vite akademike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2018- 2019 janë angazhuar në këtë program studimi 57 pedagogë nga të cilët 36 PAE dhe 21 PAK;</li> <li>2. Për vitin akademik 2019- 2020 janë angazhuar në këtë program studimi 57 pedagogë nga të cilët 36 PAE dhe 21 PAK;</li> <li>3. Për vitin akademik 2020- 2021 janë angazhuar në këtë program studimi 54 pedagogë nga të cilët 38 PAE dhe 16 PAK;</li> <li>4. Për vitin akademik 2021- 2022 janë angazhuar në këtë program studimi 65 pedagogë nga të cilët 41 PAE dhe 24 PAK;</li> <li>5. Për vitin akademik 2022- 2023 janë angazhuar në këtë program studimi 64 pedagogë nga të cilët 42 PAE dhe 22 PAK;</li> </ol>																																																															
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2018- 2019</th> <th colspan="2">2019- 2020</th> <th colspan="2">2020- 2021</th> <th colspan="2">2021- 2022</th> <th colspan="2">2022- 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>6</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>11</td> <td>6</td> <td>16</td> <td>8</td> <td>15</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table>										Tituj/ grada	2018- 2019		2019- 2020		2020- 2021		2021- 2022		2022- 2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	4	3	4	3	4	3	4	2	4	3	Prof. Asoc.	4	6	4	6	4	7	4	6	6	6	Dr./PhD.	9	8	9	8	11	6	16	8	15	7
Tituj/ grada	2018- 2019		2019- 2020		2020- 2021		2021- 2022		2022- 2023																																																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																						
Prof.Dr.	4	3	4	3	4	3	4	2	4	3																																																						
Prof. Asoc.	4	6	4	6	4	7	4	6	6	6																																																						
Dr./PhD.	9	8	9	8	11	6	16	8	15	7																																																						

SPA	7	-	7	-	7	-	7	-	8	3
Msc.	12	4	12	4	12	-	10	6	9	3
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>21</b>	<b>36</b>	<b>21</b>	<b>38</b>	<b>16</b>	<b>41</b>	<b>24</b>	<b>42</b>	<b>22</b>

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Stomatologji, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc (18% - 28%), i cili kryesisht angazhohet si staf mbështetës në realizimin e laboratoreve dhe praktikave profesionale.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të evidentuara dhe vështirësive për të rekrutuar personel akademik me tituj për shkak të pezullimit të doktoraturave, *GVJ i sugjeron insitucionit të vijojë këto përpjekje për të rritur cilësinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për katër vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	4395	3222	1173	73% / 27%
2020-2021	2690	2124	566	78% / 22 %
2021-2022	5301	4097	1204	77% / 23%
2022-2023	6019	4955	1064	80% / 20%

Nga tabela rezulton që për 4 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.

	<p>Ngarkesa mësimore shpërndahe në përputhje me kualifikimet e pedagogut, titullin/gradën akademike, eksperiencën profesionale si dhe drejtimin kërkimor të tij, duke bërë përshtatjet më të mira me lëndët e programit mësimor. Personeli i angazhuar në programin e studimit përmbush kërkesa ligjore përsa i takon ngarkesës mësimore.</p> <p><i>Ev. 22.2: Cv-të stafit akademik;</i>  <i>Ev.7.0: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Stom;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur ndryshime të mëdha. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis personelit akademik dhe institucionit, të cilat kanë të parashikuara mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi.</p> <p><i>Ev 22.3: Kontrata e punës tip PAE, PAK;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e burimeve njerëzore, ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësi bazë drejt njësisë kryesore, andej drejt Rektorit. Kërkesat për punësim miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pastaj lajmërimi bëhet publik. Rektori ngre komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik.</p> <p><i>Ev 22.4 : Procedura e rekrutimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se institucioni ka vendosur në dispozicion të kryerjes së programit mësimor laboratorë të ndryshëm të mirëpajisur, profesional dhe salla leksionesh, të cilat mirëmbahen nga personeli ndihmës akademik i përshtatshëm.</p>

<p>e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyre e Burrimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative. Të dhënat ruhen në letër dhe në formë statistikore.</p> <p><i>Ev 22.5: Përmbajtja e dosjes së stafit akademik;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar takimeve të realizuara në institucion rezultoi se, klinika universitare "Aldent" mbulon shumicën e orëve të praktikës. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si objekt shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, organizimin e aktiviteteve akademiko-shkencore, si dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta brënda dhe jashtë vendit. Në rastet kur institucionet bashkëpunuese mirëpresin studentët për kryerjen e praktikave profesionale, gjithmonë ata udhëhiqen dhe mbikëqyrin nga persona të autorizuar, të cilët kanë përgjegjësi në ndarjen e grupeve të studentëve në salla ku do kryejnë praktikat sipas një planifikimi paraprak.</p>

<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Bazuar në marrëveshjet dypalëshe që UAL ka me klinikat stomatologjike private, është përcaktuar roli mbikqyrës nga personeli në klinikat pritëse, në përmbushje të detyrimeve përfundimtare të praktikës bazuar në programin mësimor. Në marrëveshje janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit e personelit në institucionin pritës. Ata ndihmojnë studentët në realizimin e praktikave në funksion të këtij programi studimi.</p> <p><i>Ev. 25 : Marrëveshje bashkëpunimi; Ev. 6.5. Leje praktike Klinike;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në programin e studimit MSc. Stomatologji, personeli akademik, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, mbështet dhe promovon avancimin në karrierë të tyre. Megjithatë, <u>GVJ sugjeron që institucioni të rrisë më tej cilësinë e stafit akademik.</u></i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin</p>	<p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e</p>

<p>e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë, si edhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve, të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion. UAL përfshin në strukturën e tij 4 godina dhe është i përshtatur për numrin e studentëve që mirëpret, duke ofruar mjedise mësimore si salla leksionesh, seminaresh, 40 laboratorë dhe zona rekreacioni.</p> <p><i>Ev.15.2: Relacion infrastrukture;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vizitoi auditorët mësimorë, të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundësojnë demonstrimin me video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë mësimorë mjekësore dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor Msc në Stomatologji, si: laboratorët paraklinikë, histologjik, mikrobiologjik, dentistrisë paraklinike me fantoma dhe laboratorët e protetikës fikse e të lëvizshme, të cilat përdoren më së shumti në vitet e para të studimit.</p> <p>Në vitet e larta studentët kalojnë në klinkën universitare ku kryhen të gjitha procedurat nga më elementaret, si ekstraksion i dhëmbëve të qumështit, mbushje gradë e parë, fluorizime, silanime, e deri tek ekstraksionet e molarëve, mbushjet endodontike me gutaperkë të shkrirë, apo pastrimi i thellë</p>

<p>programit të studimit në tërësi.</p>	<p>paradontal. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme.</p> <p><i>Ev.15.1:Përshkrimi i laboratoreve;</i> <i>Ev.6.6: Rregullore e sigurisë në laborator;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit. Në këtë laborator zhvillohen lënda e Informatikës dhe Statistikës, gjatë së cilës studentët marrin njohuri efektive mbi përdorimin e programeve bazë kompjuterike, të statistikës SPSS dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Reruar RVB, UAL ka 40 laboratorë në funksion të programeve mjekësore,ku 11 prej tyre janë klinika stomatologjike, të cilat mbulojnë më së miri praktikat laboratorike që zhvillohen brenda institucionit. Por sikurse referohet në RVB, programet e studimit me profil mjekësor kanë një numër të konsiderueshëm orësh praktike klinike, që duhet të kryhen domosdoshmërisht me pacientë realë. Për këtë qëllim shfrytëzohen kapacitetet e UAL për trajtimin falas për pacientët, ku prioritet janë shtresat e varfra, pensionistët, femijët jetimë etj. Institucioni ka nënshkruar gjithashtu një marrëveshje me shoqatën Save the Children për depistimin, informimin dhe trajtimin e fëmijëve në zonat rurale të Elbasanit, ku janë organizuar disa aktivitete deri më tani në kuadër të këtij bashkëpunimi.</p> <p><i>Ev25.0 Marrëveshje Bashkëpunimi; RVB;</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti Aldent rezulton të ketë në përdorim infrastrukturë moderne mësimore e laboratorike dhe vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e</i></p>



	<i>procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të stomatologëve të ardhshëm.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	UAL ka në bibliotekën e tij rreth 15000 tituj librash fizikë në fushën e shkencave mjekësore dhe një listë të gjatë tituj librash të aksesueshëm në bibliotekën on-line, në platformën freebooks Hinari. Çdo student ka akses ndaj çdo libri në letër apo on-line, të nevojshëm për programin e studimit. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj, që i përgjigjet temave të programit mësimor. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dy salla me kapacitet rreth 75 poste leximi, 25 poste interneti të pajisura me kompjuter.  <i>Ev.23: Biblioteka dhe menaxhimi i saj;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në aktet rregullatore të institucionit është e përcaktuar që, çdo fillim viti njësia bazë përgjegjëse për programin mësimor përditëson literaturën mbi të cilën përgatitet syllabusi dhe zhvillohet lënda. Institucioni akordon çdo vit një fond të përshtatshëm për literaturë bazuar në kërkesat e departamentit.  <i>Ev 11.0: Sylabus, ALB;</i> <i>Ev 6.3 Rregullore departamenti STOMATOLOGJI;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës vërejmë se është në dispozicion dhe aksesohet nga çdo student sipas nevojës. Biblioteka disponon rreth 75 vende leximi dhe vende interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon rreth 15000 botime/titujsh librash profesionalë. Stafi akademik dhe studentët

<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>dispononin adresa të brëndshme email-i. Orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojave të studentëve. Ajo frekuentohet nga stafi dhe studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FSHD si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, UAL është e abonuar prej disa vitesh në bibliotekën “Hinari”, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët nëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambientet e bibliotekës dhe lidhur pa kufizim në internet dhe kohë. Shërbimi i bibliotekës ofrohet falas për çdo student apo staf akademik të universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p><i>Ev.7, Tabela 17; RVB;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Kapaciteti i bibliotekës është i bollshëm për shfrytëzimin e saj në të njëjtën kohë nga një numër i konsiderueshëm studentësh pasi ka 75 poste leximi.</p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Universiteti Aldent, është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin periodik të fondit të bibliotekës sipas kërkesave të departamenteve, si dhe i ka përfshirë këto objektiva në prioritetet e zhvillimit strategjik afatgjatë. Biblioteka është e pajisur me një sistem kompjuterik të menaxhimit, ku personi përgjegjës është i trajnuar për përdorimin e tij në mënyrë sa më efektive duke lehtësuar punën në gjetjen e titujve.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni disponon bibliotekë të hapësirë dhe literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies të programit të studimit. UAL është e abonuar prej disa vitesh në bibliotekën "Hinari", bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët nëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambientet e bibliotekës dhe lidhur pa kufizim në internet dhe kohë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**




**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UAL ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit për studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. UAL ka një databazë elektronike ku mbahet i gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. Gjithë informacioni administrohet nga Sekretaria Mësimore. Si stafi ashtu edhe studentët kanë adresën e brendshme të email (<a href="mailto:emër.mbiemër@ual.edu.al">emër.mbiemër@ual.edu.al</a>).</p> <p>FxEducation është një platformë ku koordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve, me akses të caktuar ndaj informacioneve të nevojshme për secilin.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma FxEducation, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë Universitetit: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p><i>Ev.12.3: FxEducation;</i></p> <p><i>Ev 12.4: Portali i studentit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet platformës online mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. GVJ evidenton si praktikë të mirë ngritjen e një sistemi të tillë menaxhimi, që u mundëson studentëve marrjen e informacionit të duhur për</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	vlerësimin e tyre, apo informacione të tjera gjatë zhvillimit të programit mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Gjithashtu, GVJ konstatoi përdorimin e aplikacioneve të tjera online, për shkëmbim informacioni me studentët. Në këto faqe web, lehtësisht të përdorshme nga të gjithë të interesuarit, jepen informacione të detajuara lidhur me lëndët që mbulon secili pedagog në programe të ndryshme të studimit në UAL (syllabuse, prezantime të leksioneve në powerpoint, materiale ndihmëse, informacione mbi detyrat e kursit, detyrimet e tjera lidhur me programin mësimor etj). GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAL garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.  <i>Ev.12.3: FxEducation;</i> <i>Ev 12.4: Portali i studentit;</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni disponon faqen e tij të internetit <a href="http://www.ual.edu.al">www.ual.edu.al</a> , e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën, përditësohen dhe publikohen në faqen e universitetit. Çdo informacion që lidhet me programin e studimit personelin akademik dhe aktivitete që kryen UAL, publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë, shqipe dhe angleze.  <i>Ev.20.2: Print screen ëeb UAL</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAL disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Gjithashtu ka në përdorim sistem për menaxhimin e procesit mësimor, eventeve, dokumenteve dhe materialeve didaktike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB, specifikohet se në momentin kur planifikohet hapja e programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësitë e mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor. Plani i biznesit i detajuar jep informacion mbi mbarëvajtjen e programit të studimit për një cikël të plotë studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vëndase dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion, GVJ mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve, ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brëndshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL. Çdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e	

studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të UAL. Institucioni kryen çdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit.</p> <p>Çdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare:</p> <p>Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci kontabël);</p> <p>Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);</p> <p>Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare;</p> <p>Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Situata financiare dhe bankare dëshmon se UAL ka qëndrueshmëri financiare pa detyrime ndaj të tretëve përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Nga raportet financiare të UAL dëshmohet se, institucioni ka rritje ekonomike nga viti në vit. Rritja ekonomike, që citohet edhe në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL.</p> <p><i>Ev.14.2: Të dhëna financiare të UAL për 5 vitet e fundit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL është institucion jopublik dhe garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve nga tarifat e studentëve dhe fonde të tjera që lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UAL është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e kolegjit. Gjatë vizitës dy ditore përveç takimit me stafin, nga dokumentacioni u vlerësua se Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brëndshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim, apo kalim në UAL, ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Ev 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat e UAL garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta, për të gjithë studentët, duke informuar studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, ose studimeve të pjesshme. Duke u bazuar në të dhënat e marra në takimin e GVJ dhe në Rregulloren e UAL, studenti ka të drejtë të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e parapara me Statut. Po ashtu, studenti përdor pajisjet, materialet e ndryshme klinike e ato laboratorike, gjithmonë duke u bazuar në planprogram. Studenti ka të drejtë të përfitojë bursë, të</p>



	<p>shprehë mendimin e tij/saj apo të ankohet në rast të shkeljes së rregullave dhe standardeve akademike.</p> <p><i>Ev 4: Statuti i Universitetit Aldent.Alb;</i></p> <p><i>Ev 6.1: Rregullore e Universitetit Aldent;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit, e përzgjedhjes së studentëve në faqen e tij të internetit. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, notës mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Vendimeve të Senatit Akademik. Institucioni publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore.</p> <p><i>Ev.22.3.1: Model kontratë studenti;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni informon përmes posterave dhe takimeve në shkollat e mesme, me qëllim që maturanët të njihen paraprakisht me programet e studimit dhe kriteret e pranimit që ofron UAL, si dhe t'iu jepet mundësia për t'u regjistruar. Publikimi i kriterëve për regjistrim bëhet nga ana e institucionit një vit në avanc.Kriteret shpallen dhe u bëhen të ditur të gjithë aplikantëve gjatë periudhës së informimit. Kushtet dhe procedura e transferimit të krediteve gjithashtu janë të kuptueshme dhe j'u bëhen të ditura aplikantëve nga koordinatori i programit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në RVB, para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Panairi "Work and Study" ku universiteti merr pjesë çdo vit, organizohet në qytetet kryesore të vendit, ku takimet me maturanët e studentët shërbejnë për informimin e publikut të gjerë. Në afatet e përcaktuara nga MAS për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit, stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim.</p>

	<i>Ev.24.2: Orientimi i maturanëve dhe studentëve-Ëork and Study;</i>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Referuar RVB, UAL çdo vit harton politikat e mbështetjes financiare për kandidatë me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Edhe në politikat e mbështetjes financiare ka të përfshirë dhe reduktimin e pagesës për pjesën e dy personave nga një familje, fëmijët e punonjësve të institucionit, etj.  <i>Ev.14.3 : Politikat e mbështetjes financiare të studentëve;</i>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Çdo vit akademik, që në muajin shkurt, në portalin U-Albania hidhen të gjitha kriteret e pranimit për studentët që do të aplikojnë në fund të muajit korrik. Po ashtu, këto kritere pasqyrohen në ëbsitin e Universitetit dhe në rrjete e tjera sociale që Universiteti posedon. Kriteret parashikojnë edhe rregjistrimin e studentëve të huaj, të cilët regjistrohen si çdo maturant nëpërmjet sistemit U-albania, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu, në parashikimin e kuotave vjetore, kuota të veçanta kanë dhe studentët nga trojet, si Kosova, Mal i Zi, Maqedonia, të cilët hyjnë mbasi bëjnë njehsimin e diplomës së tyre të shkollës së mesme pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe plotësojnë kriteret për t'u pranuar.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në këtë program studimi, për të cilin aplikoi, nëse rregjistrohet në Sekretarinë Mësimore brënda afateve të parashikuara. Me rregjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij duke përfshirë edhe politikat ndihmëse/ bursat. Institucioni ju ofron bursa studentëve ekselentë me notë mesatare 10, studentët e komunitetit rom-egjiptin dhe me aftësi të kufizuara. Ky program studimi është më i kërkuari nga maturanët në UAL dhe mesatarja në hyrje çdo vit është më e lartë për shkak të përzgjedhjes me kujdes nga UAL të çdo studenti që pranohet.  <i>Ev.7: Tabela nr.21</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>UAL ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika e procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e</i>

	<i>studimit. Në këtë program studimi rezulton të regjistrohen studentë me rezultate të larta të maturës shtetërore</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar RVB, koordinatori i programit të studimit informon për rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë, si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës. Në bazë të vendimit të senatit akademik, studentët janë të informuar për numrin e krediteve për të kaluar në vitin pasardhës. <i>Ev 6.4: Rregullore e programit të studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen dhe specifikohen kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve. Dekani i Fakultetit ngre komisionin e vlerësimit të ekuivalentimit. <i>Ev 6.4: Rregullore e programit të studimit;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, institucioni organizon ditë orientuese, gjatë të cilave studentët informohen mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjatë orëve të para të mësimit, gjithashtu, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	Përgjegjësi i programit të studimit informon mbi procedurën e diplomimit në fillim të ciklit të studimeve, duke ju vënë në dispozicion studentëve informacionin mbi procedurat e punimit të provimit të formimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të

punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	shkollës, fletëve informuese. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASR dhe më pas në vazhdim për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron, me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to. <i>Ev.11: Syllabuset e moduleve;</i> <i>Ev.8.1, 8.2, 8.3 :Diploma;</i> <i>Ev:24.3: Fletëpalosje informuese;</i> <i>Ev 24.4 :Reklama e UAL;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Njësia përgjegjëse për programin vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve, informon mbi procedurën e diplomimit në fillim të ciklit të studimeve, informacionin mbi procedurat e punimit të provimit të formimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese.</i>			
<b>0Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit. Organizimi, kohëzgjatja dhe kreditet për secilin vit akademik janë të paraqitura edhe në faqen zyrtare të web-it.

	<i>Ev.20.2: Print screen vweb UAL : ual.edu.al;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/ ushtrime/ labore/ detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Studentët informohen për planin mësimor të programit edhe nëpërmjet tabelave informuese që gjenden në auditorin e leksioneve dhe në platformën e-learning.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron për ta mbështetje institucionale. Pedagogët në diskutime me studentët u japin informacion studentëve në lidhje me kompetencat që fitojnë në këtë program studimi dhe mundësitë që kanë për punësim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentët diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. Studentët informohen dhe përditësohen me organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orareve mësimore, orareve të praktikave etj.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<i>Ev 12.5: Rregullore e Këshillit Studentor. Alb.doc;</i> <i>Ev.24.2: Orientimi i maturanëve dhe studentëve - Eork and Study;</i>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në platformën UAL-LMS dhe Fx Education të njohura hollësisht dhe përdorura nga studentët, merret informacioni në lidhje me programin e studimit dhe organizimin e procesit mësimor. Nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit Aldent, studentët mund të përdorin edhe rubrikën "portal i studentit", në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike të lidhur me internet. Të gjitha këto rrugë informimi janë lehtësisht të arritshme edhe nëse studenti është në distancë.
<b>Konkluzione</b>	<i>Në dispozicion të studentëve, UAL vendos informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e</i>

	<i>prishme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Dosja e programit u jepet studentëve në përfundim të studimeve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>																								
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga vizita në sekretarinë mësimore rezulton se mbahet regjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit në vite sipas programeve të studimit. Këto të dhëna shfrytëzohen edhe për të nxjerrë të dhëna statistikore që kërkohen për studentët në hyrje e në dalje, notat mesatare, etj. <i>Ev 7: Tabela 21;</i>																								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studentë tërregjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për pesë vitet akademike ishte: <table border="1" data-bbox="598 1451 1394 1841"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të cregjistruar</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>126</td> <td>2</td> <td>124</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>145</td> <td>19</td> <td>126</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>172</td> <td>26</td> <td>146</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>188</td> <td>27</td> <td>161</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>171</td> <td>11</td> <td>160</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar	Total	2018-2019	126	2	124	2019-2020	145	19	126	2020-2021	172	26	146	2021-2022	188	27	161	2022-2023	171	11	160
Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar	Total																						
2018-2019	126	2	124																						
2019-2020	145	19	126																						
2020-2021	172	26	146																						
2021-2022	188	27	161																						
2022-2023	171	11	160																						

	<p><i>Ev 7: Tabela 21;</i></p> <p><i>Vizita ne Instiucion;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me sekretarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarëvajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit dhe atë me anë të regjistrave të notave dhe të frekuentimit, rregjistrat të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve, përgjatë 5 viteve të ciklit të studimit. Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mësimore (shembull dosje studenti). UAL ka database ku ruhen në format elektronik të dokumentacionit dhe të dhënat personale të studentit.</p> <p><i>Ev 12.3 Platforma e menaxhimit online FX Education.Eng;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Duke iu referuar RVB dhe takimit të GVJ, u konfirmua se Arkivi kompjuterik garanton sigurinë e informacioneve dhe qasjen e lehtë të të dhënave në rast nevojë. Në UAL mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti bëhen në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Edhe studentët u shprehën të kënaqur me sistemin e menaxhimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni harton raportin vjetor për të gjitha njësitë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Nga të dhënat e deritanishme shumica e studentëve të diplomuar në këtë program studimi e marrin që në herën e parë provimin e licensës. Numri i të diplomuarve të cilët konvertojnë diplomën dhe punësohen jashtë vendit janë në rritje dhe institucioni komunikon nëpërmjet email-it zyrtar për vërtetësinë e të dhënave të aplikantëve që kërkohen nga institucione të huaja.</p> <p><i>Ev. 5.1 Analizë Alumni;</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit dhe sekretarisë mësimore, UAL administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Databaza elektronike e studentëve alumni përditësohet vazhdimisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në statutin dhe rregulloren e UAL, parashikohet përfshirja e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kryetari i Senatit studentor është edhe përfaqësues i studentëve në Senatin akademik dhe pjesë e mbledhjeve dhe diskutimeve periodike. <i>Ev4: Statuti i Universitetit Aldent. Alb;</i> <i>Ev 6.1: Rregullore e Universitetit Aldent. Alb;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët përfaqësohen në Senatin Studentor, me një senator për çdokurs, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, grupi i punës GVB, komisioni i kërkimit shkencor, senati akademik.  Kjo u konstatua dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion ku Senati, NJSBC, grupi i punës RVB, e kishin prezent përfaqësuesin studentor. Studentët gëzojnë të drejtat e tyre që respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit.



<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni në vazhdimësi është i hapur dhe me vëmendje të veçantë për propozimet e studentëve. Këtu ka një rol të rëndësishëm alumini - IAL mbante kontakte të vazhdueshme me studentët që vazhdojnë cikle të tjera jashtë vendit, apo që kanë aplikuar për njohje diplome dhe këta studentë jepnin opinionet e tyre për përmirësimin e kurrikulës konform programeve të ngjashme në vendet perëndimore.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga takimi me studentët, por edhe nga rishikimi i dokumentacionit, UAL i jep mundësinë studentit që të japë mendimin e tij rreth barazisë së vlerësimit të provimit. Gjithashtu, studentit i jepet mundësia e ankimit për rezultatin e provimit, përmes një procedure të rregullur, të paraparë në Rregulloren e Përgjithshme të IAL dhe rregulloren e sekretarsë.</p> <p><i>Ev: 12.2: Rregullore e sekretarisë; 6.1 Rregullore e Universitetit Aldent.Alb;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në UAL studentët janë organizuar në strukturat e tyre. Ata marrin pjesë në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit, e cila është vazhdimisht e përditësuar si dhe nga zyrat përkatëse.</p> <p>Në Universitetin Aldent, Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës mbledhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve në programin e studimit Stomatologji. Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara në bashkëpunim të ngushtë me departamentin dhe vazhdon deri mbas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Ev.12.6: Rregullore e Tutoriatit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p> <p>Nga takimi me studentët, doli që ndihma e pedagogëve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte shumë efektive. Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës në mënyrë periodike azhuron të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar, i përpunon dhe ruan ato, dhe i bën të disponueshme për autoritetet drejtuese.</p> <p>Në Universitetin “Aldent” funksionon zyra e Zhvillimit të Karrierës, e cila ofron këshillim për zhvillimin e një karriere të suksesshme për të gjithë studentët. Shërbimet që ofrohen në këtë njësi janë:</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja e potencialeve dhe shprehive vetjake;</li> <li>- Identifikimi i lidhjeve midis diplomës që zotëron dhe mundësive për karrierë;</li> <li>- Identifikimi i burimeve për pozicione të veçanta pune;</li> <li>- Udhëheqje akademike;</li> <li>- Zbulimi i strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës;</li> <li>- Identifikimi i aftësive dhe shprehive;</li> <li>- Shkrimi i rezymeve, letrave të interesit dhe CV-ve;</li> <li>- Përgatitja për intervista pune;</li> <li>- Përcaktimi i objektivave të karrierës.</li> </ul> <p><i>Ev24.1:Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL si institucion i konsoliduar, ka hartuar dhe zbaton procedura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave. Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara në bashkëpunim të ngushtë me departamentin dhe vazhdon deri mbas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UAL ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores dhe ku përcaktohet që çdo fillim viti akademik vlerësohen dhe përmirësohen metodat mësimdhënëse, sipas lëndëve dhe fushës së studimit. Gjithashtu, UAL ka hartuar udhëzuesit përkatës për përdorimin e teknologjisë së mësimdhënies dhe studimit.  <i>Ev.6.1: Rregullore Universitetit Aldent;</i> <i>Ev 21.1: Rregullore e NJSBC.Alb.pdf;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	NJSBC përpiqet për monitorimin e proceseve të brëndshme të sigurimit të cilësisë, të cilat kanë nevojë të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Çdo vit akademik, NJSBC në bashkëpunim me departamentet monitoron dhe vlerëson aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. NJSBC aplikon pyetësorë të cilët plotësohen nga stafi akademik.  <i>Ev 21.2: Pyetësori i stafit;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UAL ka zhvilluar mekanizma që garantojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet NJSBC. NJSBC e kryen këtë objektiv përmes zhvillimit të anketës dhe plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime. Pyetësorët analizohen dhe NJSBC përgatit raportin vjetor të anketimit të studentëve.  <i>Ev: 12.1: Rregullore e provimeve;</i> <i>Ev 21.3 Pyetësori i studentëve;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UAL u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC, në nivel institucioni. Referuar RVB, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor, i cili i përcillet Senatit Akademik. Ky raport i dorëzohet i detajuar Rektorit, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkretë. Për problematikat e evidentuara diskutohen mundësitë e përmirësimit në senat dhe në mënyrë individuale komunikohet për gjetjet problematike.</p> <p><i>Ev 21.1.1 : Raport NJSBC;</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UAL nga vlerësimet e kryera përmes anketimeve të studentëve, bën të mundur të nxjerrë në pah praktikat e mira të përmenduar nga studentët, çfarë motivon personelin akademik të përmirësojë metodat e mësimdhënies. Këto procese realizohen duke përfshirë të gjithë kontribuesit e institucionit që të ndihmojnë në krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional.</p> <p><i>Ev 5: Strategjia e institucionit;</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAL është institucion me ekesperiencë në fushën e sigurimit të cilësisë. Ai ndjek politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni ka në përdorim udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, Statutit dhe Rregulloreve të UAL, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Përgjegjësia

<p>Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sipas <i>nenit 15</i> të Rregullores së Institucionit, NJSBC është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Një tjetër dokument i rëndësishëm, në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë është dhe Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që paraqet: parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë; proceset dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies &amp; mësimnxënies; vlerësimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e shërbimeve për studentët, infrastrukturën dhe menaxhimin në UAL.</p> <p><i>Ev 21.1: Rregullore e NJSBC.Alb.pdf;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAL i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.</p> <p>Konkretisht, me vendimin Nr.01 të Bordit të Akreditimit, datë 27.01.2023 UAL ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 26.01.2028. Ndërsa programi i studimit është në proces riakreditimi.</p> <p><i>Ev 6.1: Rregullore Universitetit Aldent;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret e UAL paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe</p>

institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti (analizat vjetore përkatëse) ku përfshihen edhe rezultatet e pyetësorëve dhe studimeve gjurmuese. Rëndësia e implementimit të standardeve të cilësisë u shpjegohet në vazhdimësi të gjithë studentëve të rinj dhe atyre që marin pjesë në programet e ndryshme ekstrakurikulare.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Në rregulloret e UAL paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe	<p>Njësia ofruese e programit të studimit monitoron ecurinë e programit të studimit, si edhe vlerëson syllabuset e lëndëve konform planit mësimor.</p> <p>Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brëndshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu, institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin të gjithë programet; njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse paraqesin një raport vjetor, i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR.</p>

<p>planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>Ev 21.1.1 : Raport NJSBC;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Universiteti Aldent ofron programe studimi të profilizuara vetëm në fushën e shkencave mjekësore; formimi i profesionistëve në këtë fushë është pjesë e misionit dhe strategjisë së universitetit dhe performanca e tyre vlerësohet çdo vit.</p> <p>Referuar RVB raporti vjetor i NJSBC përfshin rezultatet e pyetësorëve, duke vlerësuar përqindjet e cdo alternative për përgjijget si dhe duke komentuar rezultatet.</p> <p><i>Ev 21.1.1 : Raport NJSBC;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e</p>	<p>Në takimet me drejtuesin e Departamentit dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në UAL përdoren procedura formale për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik;</li> <li>▪ në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies;</li> <li>▪ monitorime të procesit mësimor &amp; analiza në mbledhjet e departamentit;</li> <li>▪ pjesëmarrje e pedagogëve të rinj në leksionet e pedagogëve me eksperiencë etj.</li> </ul>



<p>arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ vlerëson angazhimin e UAL në realizimin e anketimeve online me studentët e diplomuar, e intervistave gjatë aktiviteteve si panairi i karrierës, si dhe hartimin e raporteve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p> <p>Sistemi i tutorëve/kujdestarëve të grupeve të studentëve, është një tjetër mënyrë permanente intervistimin e studentëve për të gjitha aspektet e procesit arsimor. Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik raporte mbi problematikat e hasura gjatë procesit akademik; gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave në lidhje me mirëfunksionimin dhe angazhimin e studentëve në orët e praktikave.</p> <p><i>Evidencë: 24.2, 24.3: Pyetëtori i studentëve dhe i stafit;</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. NJSBC dhe departamenti monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.4**




**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAL, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në funksion të procesit akademik ka një angazhim të shumëfishtë që përfshin personelin e pritjes, tutorët akademikë, përgjegjësin e programit, sekretarinë mësimore, si dhe drejtuesit e njësive bazë që janë në kontakte të vazhdueshme me studentët dhe stafin e çdo programi studimi.</p> <p><i>Ev.7: Tabela 24;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Çdo fakultet përfaqësohet nga një pedagog në njësinë e SBC, kështu që komunikimi i problematikës dhe detyrave nga njësia në fakultet dhe anasjelltas realizohet me sukses. Komunikimi me studentët realizohet nëpërmjet pyetësorëve, nga ku raportohet problematika më e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të gjithë anëtarët e grupeve vjetore të punës së njësive të SBC janë pedagogë të brendshëm dhe përfaqësues të departamenteve të rëndësishme administrative të universitetit, të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me mësimdhënien dhe problemet e lidhura me të.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantojë përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>GVJ vlerëson se UAL garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p>NJSBC bashkëpunon me departamentet si njësi bazë, në mënyrë që ato të realizojnë rritjen dhe ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies konform rregullores së njësive. NJSBC funksionon konform rregullores së saj; ajo bashkëpunon me të gjitha hallkat e</p>

studentëve të programit të studimit.	universitetit për të zhvilluar procesine vlerësimit të brendshëm të universitetit dhe të gjithë programeve të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik përgjegjës të programit të studimit, GVJ konstatoi se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nëpërmjet politikave të institucionit mundësohet angazhimi i aktorëve të jashtëm në mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe aksesimi i kontributeve të tyre në procesin e vlerësimit të cilësisë së këtij programi. Anëtarët e stafit të angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimin akademik dhe eksperiencën profesionale për të kontribuar në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit. <i>Ev21.1: Rregullore NJSBC;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e sigurimit të cilësisë-së të programit të studimit dhe informon ata në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Stafi dhe studentët janë pjesë e grupeve të vlerësimit dhe proceseve të brendshme që realizohen.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAL, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare ëeb të tij të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Referuar RVB, njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor, i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkretë. Për problematikat e evidentuara diskutohen mundësitë e përmirësimit në senat dhe në mënyrë individuale komunikohet për gjetjet problematike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se raportet e analizave të zhvilluara në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti shoqërohen me konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe të problematikave të evidentuara. Në mbledhjet e departamentit, stafi akademik analizon në mënyrë aktive ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjeron rekomandime në përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve në nivel njësie bazë dhe kryesore, si dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet në nivel fakulteti plani i veprimit për vitin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Nga shqyrtimi i raporteve të analizës së veprimtarisë në nivel departamentit, fakulteti dhe universiteti, GVJ konstatoise raportet përfshijnë dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra. Gjithashtu, përfshirja e indikatorëve dhe afateve të realizimit të aktiviteteve sipas strukturave përgjegjëse në planin e veprimit për vitin akademik</p>

vijim të cilësisë së programit të studimit.	të hartuar në nivel fakulteti, garanton vlerësimin efektiv të veprimtarive për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. <i>Ev 21.1.1: Raport NJBC.pdf;</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në takimet me drejtuesin e Departamentit dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin dhe përkushtimin e personelit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes analizave dhe veprimtarive periodike me pedagogët dhe studentët në funksion të këtij kriteri, përditësimeve të materialeve mësimore, publikimeve në faqen zyrtare ëeb të UAL me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. <i>Ev: 19: Trajnime stafi UAL;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit zhvillohen në mënyrë transparente dhe efektive me të gjithë stafin dhe studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## **Përfundime të Vlerësimit të Programit të Integruar të Nivelit të Dytë “Master i Shkencave në: “Stomatologji”**

### **a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Universiteti Aldent është institucion jo publik i konsoliduar që operon prej shumë vitesh në Shqipëri. Gajtë kësaj periudhe ka dëshmuar qëndrueshmëri, zhvillim progresiv dhe cilësi e vlerësuar në procese të ndryshme të akreditimit;
2. Programi i studimit rezulton të jetë një nga më të kërkuarit në vend në fushën e stomatologjisë duke mundësuar në këtë mënyrë përzgjedhjen e studentëve më të mirë në hyrje;
3. UAL disponon infrastrukturë moderne në funksion të veprimtarive akademike dhe veprimtarive të tejtra që zhvillon institucioni;
4. Në funksion të programit të studimit, janë vënë në dispozicion një numër të madh laboratorësh për zhvillimin e praktikave laboratorike të pajisura me pajisjet dhe teknologjinë më të fundit;
5. Në fushën e stomatologjisë institucioni rezulton të ketë nivel të lartë bashkëpunimi ndërkombëtar, partnerë brenda dhe jashtë vendit, sektorin privat të dentistrisë etj;
6. Në programin e studimit është angazhuar personel akademik i kualifikuar dhe të përkushtuar me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e stomatologjisë dhe shërbimit dentar;
7. Institucioni ka nivel të kënaqshëm të përdorimit të teknologjisë, sistemeve informatike e të mësimdhënies ccka i mundëson institucionit të administrojë informacionin në kohë reale dhe ta verë atë në funksion të programit;
8. Institucioni ka aktivitetet kërkimor në fushën e dentistrisë, zhvillon veprimtari kërkimore dhe stimulon dhe mbështet personelin akademik dhe studentët të marrin pjesë në këto veprimtari;
9. Shërbimet ndaj studentit si ato infrastrukurore, logjistike, mbështetje në mobilitete, trajnime pjesëmarrja në evente, vlerësohen në nivel mjaft të lartë;
10. Programi i studimit rezulton të ketë nivel të lartë të punësimit të studentëve ccka ndikon në reputacionin pozitiv të tij;

### **b. Pika të dobëta:**

1. Përfshirja e stafit në kërkim shkencor, projekte studimore, konferenca etj, konsiderohet jo ende në nivelin e kërkuar; (*standarti II.7, kriteri 1*)
2. Angazhimi i një numri të ulët në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc; (*standarti IV.1, kriteri 1*)

## **Rekomandime**




1. Një angazhim edhe më i madh i institucionit në mbështetjen e stafit akademik në projekte kërkimore dhe shkencore;
2. GVJ rekomandon që insitucioni të marrë masa për të rritur cilësinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
3. Departamenti të shpërndajë për studentët në këtë prograt të studimit, temat e diplomave në vitin e 4 të studimeve me qëllim që studentët të kenë një kohë më të gjatë përgatitje;

### **Conclusions for the Evaluation of Integrated Program at the Second Level "MSc. Dentistry"**

#### **a. Strengths and Affirmations:**

1. Aldent University is a consolidated non-public institution that has been operating for many years in Albania. During this period, it has proven stability, progressive development and quality, evaluated in various accreditation processes;
2. The study program turns out to be one of the most sought-after in the country in the field of dentistry, thus enabling the selection of the best incoming students;
3. UAL has modern infrastructure in function of academic activities and other activities that the institution develops;
4. In function of the study program, a large number of laboratories have been made available for the development of laboratory practices equipped with the latest equipment and technology;
5. In the field of dentistry, the institution has a high level of international cooperation, partners inside and outside the country, the private sector of dentistry, etc.;
6. Qualified and dedicated academic personnel with many years of experience in the field of dentistry and dental services have been engaged in the study program;
7. The institution has a satisfactory level of use of technology, IT and teaching systems, which enables the institution to administer information in real time and to include it in the program section;
8. The institution has research activity in the field of dentistry, develops research activities and stimulates and supports the academic staff and students to participate in these activities;
9. Services to the student, such as infrastructural, logistical, mobility support, training, participation in events, are evaluated at a very high level;
10. The study program turns out to have a high level of student employment, which affects its positive reputation;

#### **b. Weak points:**



1. Staff involvement in scientific research, study projects, conferences, etc., is considered not yet at the required level; (*standard II.7, criterion 1*)
2. The engagement of a low number of academic staff with Msc. in the teaching process in this study program; (*standard IV.1, criterion 1*)

### **Recommendations**

1. The department have to distribute to the students in this study program the topics of the diplomas in the 4th year of studies, in order to the students to have a longer preparation time;
2. An even greater commitment of the institution in supporting the academic staff in research and scientific projects;
3. GVJ recommends that the institution take measures to increase the quality of the academic staff engaged in this study program;





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X